



**HULUMTIMI PËR PRITJET E TË RINJVE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË**



Autorë

Dane Talleski
Ivan Damjanovski
Nenad Markoviç
Vlladimir Bozhinovski

Shkup, 2006

Botuesi
Fondacioni Fridrih Ebert – Zyra Shkup
Bulevardi “Sh.Klimenti i Ohrit” 21/1, 1000 Shkup
www.fes.org.mk

Për botuesin
Shtefan Denert

Përkthimi
Ismet Bitik

Lektura
Ismet Osmani

Përgatitja teknike
PROMO DSGN

Tirazhi
150

CIP – Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”,
Скопје

316.654:316.346.32-053.6(497.7)(047.31)
316.346.32-053.6:316.654(497.7)(047.31)

HULUMTIMI për pritjet e të rinjve në Republikën e Maqedonisë /
autorë Dane Talleski, Ivan Damjanovski, Nenad Marković, Vladimir
Bozhinovski ; [përkthimi Ismet Bitik]. – Shkup : Fondacioni
Fridrih Ebert, 2007. – 54 стр. : граф. прикази ; ? см

Превод на делото: Истражување за очекувањата на младите во
Република Македонија / Ненад Марковиќ, Дане Талески, Владимир
Божиновски, Иван Дамјановски. – фусноти кон текстот

ISBN 978-9989-109-38-6

1.Talleski, Dane

а) Младина – Јавно мислење – Македонија – Истражувања
б) Јавно мислење – Младина – Македонија – Истражувања
COBISS.MK-ID 68062218

PËRMBAJTJE

PARATHËNIE 7

REZYME 8

SITUATA NË VEND DHE PERCEPCIONET E PËRGJITHSHME 13

Percepione për institucionet publike dhe bashkësitë ndërkombëtare 13

Percepione për angazhimin shoqëror dhe involvimi institucional 16

Percepione për marrëdhëniet ndëretnike 17

Percepione për korrupsionin në Maqedoni 19

Percepione për të drejtat e grupeve të caktuara sociale 21

MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE 27

Percepione mbi procesin e përafrimit drejt Bashkimit Evropian 27

Percepione mbi ndikimin e BE mbi parametrat kryesore shoqërore 28

Percepione mbi procesin e përafrimit drejt NATO-së 30

Percepione mbi rolin e agjensioneve të Kombeve të Bashkuara 31

ARSIMIMI 35

Percepione për cilësinë e procesit arsimor 35

Shkathtësi praktike, tregu i punës dhe procesi arsimor 36

Refoma e sistemit arsimor, sistem i preferuar arsimor, universitete private dhe shtetërore 37

Studimi jashta shtetit dhe fenomeni i „brain-drain“ 37

EKONOMIA DHE MIGRACIONE 41

Ekonomia 41

Migracione 43

ANEKS 47



PARATHËNIE

Me këtë studim të pritjeve të cilat i ka gjenerata e re në moshën 18-30 vjeçare, Fondacioni "Friedrich Ebert" dhe Instituti për demokraci "Societas Civilis" nga Shkupi, synojnë plotësimin e një zbrazësire e cila ekziston në hulumtimin shkencor të opinionit publik në Republikën e Maqedonisë. Ndonëse vazhdimisht realizohen hulumtime të dobishme për pritjet dhe mendimet e popullatës në Maqedoni, të cilat bëjnë dallime sipas përkatësisë etnike ose gjinore, moshës ose strukturës gjeografike, deri tani nuk është realizuar ndonjë anketë reprezentative për pritjet dhe mendimet e gjeneratës së re, gjegjësisht atyre të cilët e përfaqësojnë ardhmërinë e Republikës së Maqedonisë.

Pse është e rëndësishme të pyeten përfaqësuesit e gjeneratës së re, për mënyrën në të cilën e kuptojnë gjendjen dhe zhvillimet në Republikën e Maqedonisë? Përgjigjet e tyre në pyetjet për kuptimin të cilin e kanë për gjendjen e përgjithshme, ekonominë dhe emigracionin, arsimin dhe marrëdhëniet ndëretnike, e tregojnë pasqyrën e detajuar të mënyrës në të cilën gjenerata e re e vështron shtetin e vet, dhe njëherazi i tregon edhe mundësitë të cilat i shohin të rinjtë për ardhmërinë e tyre, sipas rrethanave të dhëna.

Ky grup i moshës e paraqet gjeneratën e cila në veçanti e mirëpret realizimin e reformave politike, shoqërore dhe ekonomike, por edhe gjeneratën e cila më së shumti do të tangohet prej çështjeve të lartëcekura, në qoftë se mbeten në Maqedoni. Kjo do të thotë se marrëdhëniet stabile ndëretnike, marrëdhëniet e mira rajonale dhe ndërkombëtare, sistemi arsimor konkurrues dhe reformat ekonomike të cilat duhet të garantojnë zhvillim stabil, do të jenë vendimtare për numrin e të rinjve të zellshëm, të cilët edhe më tej janë idealistë, do të dëshirojnë dhe do të kenë mundësi të angazhohen në zhvillimin e vendit të tyre.

Pritjet e paraqitura në këtë studim do t'i tregojë politikanëve të të gjitha partive, se çka pret kjo gjeneratë prej tyre, në cilat fusha nevojiten reformat e veçanta dhe në cilin drejtim duhet të lëvizet. Përveç disa rezultateve të cilat pjesërisht janë pritur, ky studim zbulon edhe shumë rezultate të papritura, qoftë pozitive ose negative. Shpresojmë se rezultatet e hulumtimit do të lexohen me kujdes nga përfaqësuesit politikë dhe ekonomikë, si dhe përfaqësuesit e punëdhënësve, me qëllim që t'i ekzaminojnë strategjitë dhe programet e tyre, nga aspekti pikëvështrimeve të ardhshme, dhe t'i korrigjojnë ato sipas nevojës. Gjenerata e re është shpresa e secilit vend, por edhe grupi më i lëvizshëm i popullatës. Në qoftë se kornizat e rrethanave largohen shumë nga pritjet e këtij grupi, atëherë të rinjtë do ta kërkojnë fatin e tyre jashtë vendit. Ky nuk guxon të jetë modeli për ardhmërinë e Republikës së Maqedonisë.

Shtefan Dehnert,
Fondacioni Friedrich Ebert

REZYME

Hulumtimi për pritjet e të rinjve paraqet një nga projektet e para të këtij karakteri i cili në tërësi i përfshinë perceptcionet e të rinjve në Republikën e Maqedonisë në lidhje me çështjet vitale socio-ekonomike, të brëndshme dhe të jashtme politike, si dhe çështjet nga sfera e arsimit, migracioneve, të të drejtave të njeriut etj. Hulumtimi është realizuar nga ana e Fondacionit Fridrih Ebert – Maqedoni, kurse është realizuar në partneritet me Institutin për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup. Hulumtimi përbëhet nga dy pjesë: anketimi i opinionit publik te popullata e re dhe analiza e të dhënave në bazë të rezultateve të fituara. HPR (Hulumtimi për pritjet e të rinjve) u realizua në periudhën prill-qershor të vitit 2006 në nivel nacional.

Hulumtimi i opinionit publik – metodologjia e përdorur

Anketimi i opinionit publik për nevojat e Hulumtimit për pritjet e të rinjve (HPR) u realizua në bazë të një shembulli të standardizuar dhe të stratifikuar, i cili në mënyrë reprezentative e reflekton popullatën rinore në Republikën e Maqedonisë nga aspekte të ndryshme. Në shembullin janë marr parasysh specifikat demografike të të rinjve (strukture gjinore, grupet e moshave, shkalla e arsimit, profesioni dhe përkatësia etnike) dhe u bë një ndarje përkatëse e të anketuarëve sipas vendit të jetesës (mjedisi urban ose rural dhe qyteti i Shkupit si tërësi e posaçme për arsye të specifikave të veta). Gjithashtu, në shembullin janë të përfaqësuar të anketuarit nga të gjitha rajonet në Maqedoni, çdo komunë, duke përfshirë edhe mjediset rurale që i inkludon, ishte e përfaqësuar procentualisht sipas numrit të banorëve në atë në raport me popullatën e përgjithshme.

Me anketimin u përfshinë gjithsej 1197 të anketuarit. Nga ata 697 ose 58,2% janë meshkuj, kurse 500 ose 41,8% janë femra. Në lidhje me grupet e moshave, popullata rinore ishte ndarë në tre intervale të moshës. Në bazë të kësaj ndarjeje u anketuan 456 ose 38,1% të të rinjve të moshës prej 18 deri 22 vjet, 452 ose 37,8% të moshës prej 23 deri 26 vjet dhe 289 ose 24,1% të të rinjve që u anketuan i takonin intervalit prej 27 deri 30 vjet.

Pjesa më e madhe prej tyre kanë kryer shkollimin e mesëm edhe atë 62,1%, përderisa më së paku të anketurit ose 0,7% janë me arsimim të pakryer fillor. Kategoritë tjera marrin pjesë në këtë anketim me 3,8% me arsimim fillor, 4,7% me arsimim të lartë dhe 28,8% me arsimim të kryer superior.

Në lidhje me profesionet e të anketuarëve, përqindje më e madhe, 35,8%, janë studentë, pas të cilëve pasojnë të punësuarit në biznesin privat me 19,8% dhe të papunësuarit me 19,1%, përderisa më së paku janë të përfaqësuar bujqit me 1,4%.

Sipas përkatësisë etnike janë anketuar 74,8% Maqedonë, 22,5% Shqiptarë, 1,4% Turqë, 0,8% Serbë, 0,1% Romë dhe 0,3% Vllehë. Sipas vendit të jetesës, 25,7% jetojnë në fshatra, 19,2% në qytete më të vogla, 30,1% në qytete më të mëdha dhe 25% janë banuar në kryeqytet në Shkup.

Popullata e re e anketuar relativisht proporcionalisht ishte e shpërndarë, në bazë të njësive zgjedhore në të cilat përkasin edhe atë: 16,5 % në Njësinë zgjedhore (Nj.Z.) 1, 16,4% në Nj.Z. 2, 17,1% në Nj.Z. 3, 14,5% në Nj.Z. 4, 18% në Nj.Z. 5 dhe 17,5% në Nj.Z. 6.

Analiza e të dhënave nga hulumtimi i realizuar i opinionit publik është bërë në lidhje me përgjigjet e fituara të

të anketuarëve të cilat pastaj janë kryqëzuar sipas karakteristikave demografike, vendbanimit dhe njësisë zgjedhore të cilëve u përkasin.

Anketimi i opinionit publik u realizua prej 10 deri 28 maj të vitit 2006, kurse supervizionin e stafëve, përpunimin e të dhënave dhe analizën në bazë të rezultateve të fituara i bëri stafi profesional i Institutit për Demokraci "Societas Civilis" nga Shkupi.

Perceptcionet e të rinjve në Republikën e Maqedonisë – pasqyrë e shkurtë

Pjesa e dytë e Hulumtimit të pritjeve të të rinjve (HPR) në Republikën e Maqedonisë përfshinë analizën e mbështetur në të dhënat e fituara nga hulumtimi i opinionit publik, si dhe burime tjera që shërbejnë si bazë komparative në lidhje me temat e anketuara. Sa i përket temave të hulumtuara, analiza përfshinë katër fusha, edhe atë: situata e brëndshme politike në vend dhe perceptcione të përgjithshme, marrëdhëniet ndërkombëtare, arsimimi dhe pjesa që ka të bëjë me ekonominë dhe migracionet. Secila prej këtyre pjesëve është shoqëruar me konkluzione adekuate (përkatëse) dhe rekomandime deri te faktorët e interesuar në Republikën e Maqedonisë, të Qeverisë dhe „policy-makers“ të tjerë, e deri te mediumet dhe sektori joqeveritar. Përveç këtyre aktorëve social, vetë grupi qëllimor i të rinjve prej 18 deri 30 vjet e përfaqëson publikun themelor të cilit kjo analizë i është dedikuar.

Si temë e parë në analizën e HPR-së paraqiten **perceptcionet e përgjithshme të të rinjve, si dhe perceptcionet për situatën e brëndshme politike** në Republikën e Maqedonisë. Në këtë kuptim HPR-ja tregon qartë një pasqyrë letargjike te popullata rinore e shoqëruar me mosbesim (ose besim shumë i vogël) drejt institucioneve shtetërore. Përveç nivelit të ultë të aktivitetit social, ekziston edhe perceptcioni pozitiv për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare që tregon në konsolidimin e ngadalshëm, por gradual të kësaj sfere të jetës shoqërore. Nga ana tjetër, te të rinjët ekziston besim i madh drejt sektorit të tretë dhe institucioneve religjioze.

Në lidhje me perceptcionet tjera të ndërlidhur për perceptcionet e përgjithshme dhe situatën e brëndshme politike, është e qartë dhe e evidente se ekziston një konsensus te njerëzit e ri se korrupsioni është problemi më flakruer i shoqërisë maqedonase dhe faktori më i rrezikshëm për ekonominë maqedonase, por shqetëson përqindja e të rinjve të cilët edhe përkundër kësaj do ta kishin pranuar korrupsionin si praktikë profitabile. Ndërkaq, në lidhje me sferën e të drejtave të njeriut, është e evidente situata e senzitivitetit dhe solidaritetit social te të rinjët ndaj personave të hendikepuar dhe ndaj personave social të rrezikuar, por shqetëson mosbesimi dhe rrezistenca ndaj përmirësimit të të drejtave të femrave dhe popullatës homoseksuale.

Perceptcionet e të rinjve për **marrëdhëniet ndërkombëtare** indikojnë pikëpamje shumë interesante dhe pozitive në lidhje me më shumë çështje nga kjo sferë. Kështu, çështja e integritetit në Bashkimin Evropian të Republikës së Maqedonisë nuk është sjell në dyshim nga ana e njerëzve të rinjë dhe paraqet pikë rreth së cilës ekziston pajtim maksimal te të rinjët në lidhje me të gjitha kategoritë demografike. Kjo shkon deri atje që mbështetja për asociimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian është e shprehur më fuqimisht te popullata rinore se sa në nivel

nacional (te të gjitha grupet e moshave bashkarisht), kurse Bashkimi Evropian njihet si faktor stabilizues dhe s'gens i përparimit eventual ekonomik të Maqedonisë, pa ndjenjën e rrezikimit të identitetit dhe traditave të pranueshme të bashkësitë në shtet.

Në lidhje me perceptcionet tjera në temën e marrëdhënieve ndërkombëtare, të rinjët në shtet shikojnë pozitivisht në NATO-alenacën dhe anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në atë, edhe përkundër dallimeve të vogëla në perceptcionet të të anketuarit nga bashkësi të ndryshme etnike. Kurse, në lidhje me perceptcionet e të rinjëve ndaj punës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe agjensive të saja të specializuara, fitohet përshtypje se është e nevojshme një njohje më esenciale të të rinjëve në Maqedoni me punën dhe rolin e tyre me qëllim të popullarizimit më të madh.


Të anketuarit në suazat e HPR-së në Republikën e Maqedonisë tregojnë raport real kritik edhe ndaj temës së tretë të interesimit të analizës – **arsimimit**. Edhe përkundër notës relativisht të mirë që popullata e re e jep për sistemin arsimor në Maqedoni, përgjigjet në pyetjet tjera të kësaj teme tregojnë në skepticizmin e padyshimtë që ekziston te të rinjët në lidhje me sistemin arsimor. Kjo veçanarisht nga ajo që perceptcionet për cilësinë e arsimimit të të anketuarit e HPR-së zvogëlohen me çdo shkallë pasuese arsimore, kurse relativisht notë të keqe të rinjët tregojnë edhe ndaj shkathtësive praktike që sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë i ofron, si dhe ndaj mundësisë për gjetjen e punës me shkallën konkrete edukative që ata e posedojnë. Nga kjo qartë mund të shihet përej nga vjen perceptcioni te popullata rinore se sistemit arsimor të Maqedonisë i nevojitet një reformë esenciale.

Nga ana tjetër, madje, te të rinjët në Republikën e Maqedonisë është evidente dëshira për vazhdimin e edukimit në botën e jashtme me theks në vendet e Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Përveç kësaj, në pjesën e arsimimit, popullata rinore tregon mendime (opinione) të ndara rreth sistemit të preferuar të arsimimit, por është e dukshme se ekzistojnë mendime të ndara edhe rreth preferencialeve në universitetet shtetërore ose private si institucione terciare përgjegjëse për arsimimin superior.

Më në fund, **ekonomia dhe migracionet** si temë e katërt, e fundit e HPR-së po reflektohet në jetën e përditëshme të të rinjëve në mënyrë të drejtëpërdrejt dhe me vetë këtë shkakton perceptcione interesante në lidhje me më shumë çështje/pyetje. Të rinjët në Republikën e Maqedonisë i perceptojnë papunësinë dhe korrupsionin si probleme më të mëdha nga sfera e ekonomisë dhe e locojnë përgjegjësinë për ballafaqimin me ato te institucionet shtetërore. Përveç kësaj, të anketuarit konsiderojnë se një pjesë e përgjegjësisë e ka edhe sistemi arsimor i përfomuar, kurse procesin e evrointegrimit e shikojnë si rrugëdalje të mundëshme nga kjo gjendje.

Perceptcionet në temën migracione te të rinjët indikojnë një potencial të madh për emigrim jashtë shtetit si rezultat i pakënaqësisë nga situata ekonomike, por, megjithatë, emigrimi perceptohet si alternativë e fundit. Një pjesë e madhe e të rinjëve tregojnë dëshirë që të emigrojnë përgjithmonë, kurse ata që do të emigronin përkohësisht e preferojnë Bashkimin Evropian si destinacion të dëshiruar.





**SITUATA NË VEND DHE
PERCEPCIONET E PËRGJITHSHME**





Përqindja më e madhe e të rinjëve në Republikën e Maqedonisë (42%) konsiderojnë se jetojnë në kushte mesatare, përderisa 29% vlersojnë se kushtet e tyre për jetesë janë të mira. E gjithë kjo në njëfarë mënyre e tregon perceptcionin realist të të rinjëve në Maqedoni, me çrast nuk mund të vërrehet retorikë defetiste dhe paraqitja e hapsirës së vetë jetësore në një konotacion negativ. Përqindjet e të rinjëve që jetojnë në kushte të këqija (18,4%) dhe kushte shumë të këqija (4%), edhe përkundër asaj që janë shumë të larta, e reflektojnë gjendjen reale në shtet. Të dhënat e hulumtimit tregojnë në proporcionalitetin e cilësisë të kushteve jetësore me nivelin e arsimit të të anketuarëve, kështu që të rinjët me arsimim të kryer superior dhe të lartë në përqindje më të madhe konsiderojnë se jetojnë në kushte të mira. Nga ana tjetër, të rinjët Shqiptarë kanë dukshëm më shumë perceptcion pozitiv për kushtet e veta jetësore se sa moshatarët e tyre të etnikumit Maqedonë. Kështu, 13,8% të Shqiptarëve (kundruall vetëm 3,6% të Maqedonëve) konsiderojnë se jetojnë në kushte shumë të mira dhe 42,8% të Shqiptarëve (kundruall 24,8% të Maqedonëve) konsiderojnë se kushtet e tyre janë të mira. Nga ana tjetër, 20% të të rinjëve Maqedonë konsiderojnë se kushtet e tyre jetësore janë të këqija. Indikative janë perceptcionet e drejtëpeshuara sipas kategorisë së vendbanimit. Edhe përkundër asaj që ekziston një perceptcion i përgjithshëm të jetës më pak cilësore në mjediset rurale dhe qytetet më të vogëla, gjithsesi pozicionet e të rinjëve që vijnë nga këto mjedise nuk janë në korelacion me këto tendenca.

Anticipimi i një ardhmërie më të mirë dhe jetë më cilësore te të rinjët është një kategori relativisht e fortë me çrast 55% të popullatës rinore në njëfarë mënyre të caktuar pret përmirësimin e standardit jetësorë. Me këtë rast, 13,2% të të rinjëve llogarisin në kushte shumë më të mira, përderisa 41,7% presin kushtet e tyre jetësore deri diku që të përmirësohen. Duke patur parasysh se vetëm 5,6% antcipojnë keqësimin e kushteve, atëherë është valide të thuhet se te të rinjët në Maqedoni mungon skepticizëm i theksuar apropos ardhmërisë vetanake. Mirëpo, nëse krahasohen pritjet me gjendjen aktuale të kushteve jetësore, mund të vërtetohet se pikëpamje pozitive ndaj ardhmërisë ka ajo pjesë e popullatës rinore që tanimë jeton në kushte të mira ose në kushte mesatare.¹ Kundruall të tyre pikëpamjeve, vetëm 20% nga të anketuarit që konsiderojnë se jetojnë në kushte të këqija presin ndonjë përmirësim.

Aspekti i participizimit të popullatës rinore në Maqedoni në sistemin politik-ekonomik dhe në shoqërinë civile dëshmon një letargji shqetësuese. 64,2% të larta të të anketuarëve nuk participojnë në punë në asnjë modus organizativ, me çrast vetëm 2% të të rinjëve janë pjesë e ndonjë organizate profesionale. E dhëna që tregon se 15% të të rinjëve janë anëtarë të partive politike, kurse vetëm 8% janë anëtarë të organizatave joqeveritare, tregon pozicionin e rudimentuar të sektorit civil në Maqedoni. Në mënyrë të plotësuar, vetëm 6% të të rinjëve aktivisht mirren me sport. Me këtë rast, në më shumë kategori, shkallë më e vogël e participimit vërrehet te të rinjët që jetojnë në Shkup. Shkalla e ulët e participimit në parti politike është karakteristikë edhe në vendet tjera ballkanike. Për shembull, në Bosnjë e Hercegovinë (BeH) vetëm 8% të të rinjëve janë anëtarë të ndonjë partie politike.²

Mirëpo, nëse krahasohen këto të dhëna me interesat reale të të rinjëve, fitohen në momente tendenca të kundërta proporcionale, me çrast mungesa e participimit aktiv edhe më shumë vjen në shprehje. Kështu, numër më i madh i të rinjëve interesohen për zbavitje dhe sport (nga 23,2%), me çrast vetëm 6% aktivisht mirren me aktivitete sportive. Dispariteti i madh i cili tregon në mungesë të mundësive ka edhe te interesi për çështje ekonomike dhe biznes (19,7%), të cilin, madje, e zbatojnë në praktikë vetëm 2% të të rinjëve. Në fund, mund të konfirmohet se popullata rinore është relativisht e depolitizuar në saje të asaj se 7% të ulta të të rinjëve interesohen për politikë, e që është për 8% më ulët nga anëtarësimi i të rinjëve në parti politike. Kjo tregon në aktivitetin e dobët të të rinjëve në partitë politike që realisht nuk kanë aspirata anëtarësimin e tyre ta instrumentalizojnë në një angazhman më serioz politik. Nëse është për qetësim, situata është shumë e ngjajshme edhe në vendet tjera të Ballkanit. Disa hulumtime tregojnë se vetëm një e treta e të rinjëve në Bosnjë e Hercegovinë voton në kohën e zgjedhjeve, përderisa vetëm 3% prej tyre janë anëtarë në organet ligjvënëse, poashtu edhe në Bullgari rreth 50% të të rinjëve e kanë parasysh apstenimin nga votimi gjatë zgjedhjeve, kurse në Shqipëri më pak se 1% të të rinjëve konsiderojnë se politika ka ndikim në jetën e tyre.³

Perceptcione për institucionet publike dhe organizatat ndërkombëtare

Perceptcionet e të rinjëve në këtë hulumtim lëviz në suazat e tendencave tanimë të përcaktuara në lidhje me besimin në institucionet ndërkombëtare dhe institucionet publike politike, por me dallime të vogëla në lidhje me organizatave private dhe atyre organizatave që kanë karakter më të gjërë shoqëror. Rezultatet janë qartazi të dukshme në [grafikonin 1](#) e parë të vendosur më poshtë. Është interesante e dhëna se përqindje më e madhe e besimit te të rinjët kanë bankat. Bankat janë simbol i fuqisë financiare dhe e mundësisë për disponim me kapital. Si të këtilla ata së bashku me firmat private, nëse jo edhe më shumë, janë simbol i shoqërisë së tregut. Fakti që të rinjët kanë besim më të madh në simbolet e sektorit privat flet se janë në masë më të madhe të orientuar drejt tregut dhe se nuk kanë përcitje të mëdha nga shteti. Pakënaqësia e tyre nga institucionet publike plotësohet, me besimin më të madh në institucionet ndërkombëtare, që ana e vet, mund të rezultoj me përkrahje më të madhe të proceseve integruese evropatlantike, por edhe të bëhet motiv për emigrim nga Maqedonia.

Edhe pse vetëqeverisja lokale ka nivel më të lartë të besimit në krahasim me institucionet tjera, fakt që sqarohet me bejvolentitetin, por edhe me painformimin e qytetarëve për vetëqeverisjen lokale,⁴ befason fakti që armata dhe policia kanë besim të lartë te të rinjët në Republikën e Maqedonisë. Besimi në armatën është një fenomen interesant, veçanarisht nëse kihen parasysh debatet dhe kërkesat për heqjen e afatit të detyrueshëm ushtarak, që edhe u realizua duke i gëzuar rreth 15.000 – 20.000 njerëz të rinj të cilët jo vetëm që i ikën shërbimit ushtarak, por edhe të dënimeve që iu kërcnuan për shkak të ikjes paraprake të obligimit ushtarak.⁵ Përgjigjet e këtilla më shumë hyjnë në kontekstin e perceptcioneve të përhjithshme në Maqedoni, se sa që janë reflektim i nevojës për siguri personale.

¹ Kështu, 76,8% nga të anketuarit të cilët konsiderojnë se jetojnë në kushte të mira, presin përmirësim të dukshëm ose ndonjëfarë përmirësimi. Gjithashtu, 77% të të anketuarëve të cilët konsiderojnë se jetojnë në kushte mesatare, presin përmirësim të dukshëm ose ndonjëfarë përmirësimi


² UNDP. Human Development Report Bosnia and Herzegovina 2000: Youth, Independent Bureau for Humanitarian Issues (IBHI), Sarajevo 2001.

³ UNICEF and World Bank. Youth in South Eastern Europe: Report of the Rome Conference on Participation, Empowerment and Social Inclusion, Rome June 2002

⁴ ISPP. Kultura politike e qytetarëve dhe ndikimi i tyre në punën e organeve të vetëqeverisjes lokale, Shkup viti 2005.

⁵ Sashko Dimevski, në gazetën Utrinski vesnik "Me ligj do të amnestohen 15 mijë rekrutë të paracaktuar"

Në kend kanë besim të rinjët në Maqedoni?



Grafikonin 1. Besim i madh dhe i pjesërishëm (në përqindje)

Sikurse edhe deri tani trendet e përcaktuara te popullata e përgjithshme, poashtu edhe te të rinjët, Parlamenti, Qeveria, Presidenti i shtetit, gjqysia dhe partitë politike kanë nivel më të ulët të besimit.⁶ Mungesa e besimit në institucionet publike politike në vendet e tranzicionit përgjithsisht sqarohet përmes dy qasjeve kryesore. Sqarimi i parë është në konstelacion me besimin e lartë në institucionet që e sigurojnë paqën dhe stabilitetin – armatën dhe policinë, që bazohet në vetëdijen autoritare, si reminiscencë e regjimit të vjetër, dhe nevoja për “dorë” të fortë në politikë. Sqarimi i dytë bazohet në faktin që konsolidimi i sistemeve demokratike ende nuk ka përfunduar edhe përshkak të pamundësisë që të vendoset një sistem i “qeverisjes së mirë”, nuk është e mundëshme që qytetarët të kenë një pjesëmarrje aktive në politikë.⁷ Për këtë arsye ata ndjehen të lën anësh nga politika dhe kanë besim të ulët në institucionet publike.

Konstatimet e këtilla ndoshta janë të sakta për proceset më të gjëra të tranzicionit, sikurse edhe për ndikimin që ata e kanë mbi opinionin më të gjërë. Por, nëse shikohen hulumtimet të krahasuara në vendet e Bashkimit Evropian për perceptcionet e të rinjëve për politikën dhe për interesin e tyre për participim, do të vërrehen rezultatet e njejta të disfavorshmesikurse edhe hulumtimet e realizuara në Maqedoni. Kështu, për shembull, ka korelacione në lidhje me faktin që pritet rreth „60% të të rinjëve të mos votojnë” në zgjedhjet parlamentare,⁸ që rezonon qëndrimin që është i

pranuar te të rinjët në Bashkimin Evropian. Ndërkaq, në hulumtimin e realizuar nga Instituti për hulumtime dhe analiya shoqërore (SORA) nga Austria në 8 vende-anëtare të Bashkimit Evropian në shembullin e 8,030 njerëzve të rinjë,⁹ rezultatet tregojnë se mesatarisht 64 përqind të të rinjëve nuk kanë interes për politikë.¹⁰ Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se të rinjët në Evropë kanë besim jashtëzakonisht të ulët në institucionet publike dhe në partitë politike. Rezultatet komparative janë prezantuar në tabelën 1 e mëposhtme.

Analiza e SORA-së tregon se të rinjët kanë nivel të ulët të socializimit politik, por edhe se faktorë të ndikimit janë participimi i tyre politik dhe shkalla e arsimimit. Nëse i marrim këto dy konkluzione dhe i testojmë në hulumtimin e të rinjëve në Maqedoni, do të shohim se edhe të dy faktorët kanë ndikim të rëndësishëm në formimin e qëndrimeve të të rinjëve. Ndërkaq, rezultatet e prezantuara në tabelën 2 tregojnë se të rinjët me shkallë më të lartë të arsimimit, definuar si shkollë e lartë ose arsimim superior, kanë besim më të lartë se sa ata që janë me arsimim të ulët ose paarsimim. Konkludim i njejtë vlen edhe për të rinjët që janë aktiv, respektivisht të rinjët që janë pasiv në jetën publike – kanë besim më të ulët në institucionet publike.

Duket se në lidhje me institucionet politike, qëndrimet e të rinjëve në masë të madhe janë kompatible me ato të moshatarëve të tyre nga vendet e Bashkimit Evropian dhe, sikurse që konkludojnë analitikët e atjeshëm,

Besimi në	IOM - Maqedoni	SORA - BE 8 vende
Qeverinë	21.6	prej 12 deri 19
Parlamentin	25.6	prej 18 deri 24
Partitë politike	19.9	prej 13 deri 18

Tabelën 1. Krahasimi komparativ i perceptcioneve të të rinjëve nga Maqedonia dhe disa vende-anëtare të Bashkimit Evropian (në përqindje)

⁶ Për më shumë detaje shiko Raporti për paralajmrim të hershëm,, UNDP, Shkup, mars 2006.

⁷ Ibid, faqe 14

⁸ Sipas tabelave dhe krostabulacioneve të Raportit për paralajmrim të hershëm nga qershori i vitit 2006, shiko <<www.ewr.org.mk>>

⁹ Hulumti është realizuar në periudhën prej vitit 2003 deri në vitin 2005 në Gjermani, Itali, Austri, Francë, Finlandë, Britani të Madhe, Estoni dhe Sllovakia. Për më shumë informacione shiko në veb faqen www.sora.at

¹⁰ Westphal, Sabine. Political Participation of Young Europeans, Vienna: SORA, 2006.

Besimi në	Me arsimim më të ulët	Me arsimim më të lartë	Mesatare	Aktiv	Joaktiv
Qeverinë	prej 17 deri 28	prej 27 deri 29	21.6	prej 20 deri 32	18
Parlamentin	prej 15 deri 21	prej 27 deri 31	25.6	prej 26 deri 33	14
Partitë politike	prej 12 deri 37	prej 22 deri 29	19.9	prej 22 deri 36	13

Tabelën 2. Faktorë që e kushtëzojnë besimin në institucionet politike, (në përqindje)

pasiviteti i të rinjve ndryshon me "procesin e pjekurisë së tyre ... dhe me kyçjen e tyre aktive në organizata të ndryshme".¹¹ Konkludimi i këtillë do të ishte më i shembulltë edhe në rastin tonë, në lidhje me qëndrimet e të rinjve. Hulumtimi tregon se pjesa në e madhe e të rinjve në Maqedoni (64,2%) nuk kanë aktivitete shoqërore, pa marr parasysh a janë në sferën e politikës, sportit, ekonomisë ose diçka tjetër. Filozofia e këtillë pasive jetësore qartasi po krijon një ndjenjë të jetërsuar ose të rrezistencës nga institucionet publike.

Por, të rinjtë në Maqedoni u janë të ekspozuar edhe ndikimeve nga kultura dominuese politike dhe perceptioneve të përgjithshme të opinionit.

Në tabelën 3 e mësipër janë rezultatet krahasuese nga hulumtimi i të rinjve me rezultatet nga Raporti për paralajmërimin e hershëm, nga marsi i vitit 2006. Pothuajse se edhe nuk ka ndonjë dallim më të madh nga qëndrimet e opinionit të përgjithshëm të institucionet e dhëna. Besimi është më i ulët në institucionet publike të sistemit, por te opinionit i përgjithshëm besimi lëviz midis 22 dhe 35 përqind, te të rinjtë ajo është më e ulët dhe lëviz prej 20 deri 25 përqind. Policia dhe armata kanë besim komparativ më të lartë, se sa që është rasti me institucionet publike. Mirëpo, besimi në to është më e ulët se sa ai që e ka opinionit i përgjithshëm në Maqedoni, kurse i njëjtë është edhe rasti edhe me institucionet religjioze. Konstelacioni i këtillë i raporteve shpie në tre konkluzione:

1. Të rinjtë në Republikën e Maqedonisë janë pasiv në lidhje me ngjarjet me karakter publik;
2. Të rinjtë janë më pak militant dhe autoritar, se sa opinionit i përgjithshëm;
3. Të rinjtë janë në masë më të madhe sekular dhe nuk i japin rëndësi të madhe religjionit.

Nëse kihet parasysh edhe fakti se të rinjtë besim

më të madh kanë në bankat, mund të nxirret konkludimi se ata janë të orientuar drejt zgjidhjes dhe tejkalimit të problemeve të tyre të përditëshme, kryesisht probleme ekonomike, kurse gjithnjë e më pak interesohen për politikën ose religjionin. Nëse kihet parasysh se për 44 përqind problemi më i madh është papunësia, atëherë është bëhet më i qartë preokupimi me problemet personale praktike.

Mirëpo, në lidhje me qëndrimet ndaj institucioneve publik duhet të kihet parasysh edhe faktorët tjerë të ndikimit, edhe atë, para se gjithash, përkatësia etnike. Ndërkaq, ekzistojnë lëvizje në parametrat e shtruar më sipër edhe atë në lidhje me besimin në policinë, armatën dhe në institucionet religjioze. Tabelën 4

Maqedonët kanë besim më të lartë në armatën dhe policinë, përderisa Shqiptarët kanë besim më të lartë në institucionet religjioze. Kjo e dhënë shpie në faktin se përkatësia etnike, gjithashtu, është faktor i cili i kushtëzon qëndrimet e të rinjve në lidhje me besimin në disa prej institucioneve. Përveç institucioneve të përmendura më sipër, dallimi në qëndrimet në lidhje me përkatësinë etnike ekziston edhe te institucionet ndërkombëtare. Te Shqiptarët, 80 deri 85 përqind kanë besim në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në Kombet e Bashkuara, përderisa te Maqedonët besimi lëviz midis 40 dhe 50 përqind. Sikurse që tregojnë analiza tjera, qëndrimet e këtyra drejtëpërdrejti janë të kushtëzuara nga perceptcionet e ndryshme të modelit të marrëdhënieve ndëretnike, që u vendos me Marrëveshjen korniz të Ohrit dhe rolin e institucioneve të ndryshme në këtë proces.¹² Megjithatë, duhet të potencohet se edhe përkundër qëndrimeve të ndryshme etnike, të rinjtë kanë relativisht besim të lartë në institucionet ndërkombëtare, edhe atë më shumë se gjysma nga të anketuarit te të gjitha institucionet. Shikuar në mënyrë komparative, qëndrimi për

Besimi në	IOM-qershor 2006	EWR - mars 2006
Qeverinë	21.6	25.2
Presidentin	25.6	35.9
Parlamentin	20	22.4
Gjyqësinë	24.1	25.4
Armatën	57	65.8
Policinë	48	57
Bankat	60.6	48.7
Vetëqeverisjen lokale	37.8	42.4
Institucionet religjioze	45.2	72.1

Tabelën 3. Krahasimi i perceptioneve të të rinjve me perceptcionet e opinionit në përgjithësi (në përqindje)

¹¹ Ibid, faqe 36

¹² Taleski, Dane. Images of Macedonia: Model of inter-ethnic relations and public perceptions, Paper delivered at the Nation States and Xenophobias: In the ruins in ex-Yugoslavia conference, Piran 13-14 May 2005

Besimi në	Maqedonë	Shqiptarë	Total
Armatën	62	49	57
Policinë	49	40	48
Institucionet religjioze	41	55	45.2

Tabelën 4. Përkatësia etnike dhe besimi i të rinjve në institucionet (në përqindje)

besim më të lartë në Bashkimin Evropian se sa në institucionet vendase theksohet edhe në konkluzionet nga anketimi i të rinjve në 8 vendet-anëtare të Bashkimit Evropian. Përveç të këto institucione, të sigurisë, religjioze dhe ndërkombëtare që kishin një rol të rëndësishëm në krizën e vitit 2001 dhe pas saj, përkatësia etnike nuk luan rol të madh në qëndrimet e të rinjve për institucionet tjera. Qëndrimet për marrëdhëniet ndëretnike do të kenë vend të posaçëm në analizën, por për një moment ta shohim perceptcionin e të rinjve për ndikimin e institucioneve në zgjidhjen e problemeve me të cilët ata po ballafaqohen.

Percepcione për angazhimin shoqëror dhe involvimin institucional

Është interesant fakti se pjesa më e madhe e të anketuarëve më së shumti presin pikërisht vetë që ti përmirësojnë kushte e veta jetësore, pa kërkuar me këtë rast ndihmë nga dikush tjetër. Një pjesë e caktuar llogarit edhe në ndihmën e të afërmeve të vetë, kurse vetëm 6,6% presin që këtë ta bëjë shteti. Pjesa më e madhe prej atyre që janë përgjigjur se vetëm vetë do ta marrin përgjegjësinë për avancimin e kushteve të jetesës, konsiderojnë se këtë do ta arrijnë me punësim të ri dhe më mirë të paguar (32,7%) ose me hapjen e biznesit vetanak (34,7% ose 20% nga numri i përgjithshëm i të anketuarëve). Sipas këtyre të dhënave fitohet përshtypje se pjesë gjithnjë e më e madhe të popullatës rinore është duke e rritur vetëbesimin e vetë dhe po i zvogëlon pritjet se problemet e tyre do të zgjidhen nga dikush tjetër.

Në saje të problemeve me të cilët po ballafaqohen të rinjtë, pjesa më e madhe prej tyre konsiderojnë se Maqedonia është duke shkuar në drejtim të gabuar. Njëkohësisht, ata po e loçojnë edhe problemin më të madh, për shkak të të cilit, sipas tyre, shteti është duke shkuar në drejtim të gabuar në përpjekjet për zgjidhjen e tij. Pjesa më e madhe e të rinjve të cilët kanë thënë se Maqedonia po shkon në drejtim të gabuar, si shkaktar më të madh për një gjendje të këfillë e konsiderojnë papunësinë dhe mospunësinë për zvogëlimin e saj (40%). Gjithashtu, përqindje e lartë janë përcaktuar për korrupsionin (32,3%), kurse 20,6% nga ky grup të të anketuarëve konsiderojnë se varfëria është problemi themelor në Maqedoni. Është interesant, por njëherit edhe është fakt shqetësues se madje 32,4% nga të rinjtë s'kundeshin të përcaktohen për drejtimin në të cilin po ecë shteti në pikëpamje të zgjidhjes së problemeve më flakruese. Mirëpo, pjesa më e madhe të këtij grupi të të anketuarëve e kanë locuar, sipas tyre, problemin më flakruar aktual, e ky është sërish papunësia, por edhe varfëria. Megjithatë, varfëria është pasojë dhe në përpjekjen për zvogëlimin e saj, përpjekje më e madhe duhet ti kushtohet zgjidhjes së shkaqeve për shkak të të cilave ajo kaplon (përfshinë) shtresën gjithnjë e më të madhe të popullsisë, e kjo është zvogëlimi i korrupsionit dhe hapja e vendeve të reja të punës.

Në masë më të madhe të rinjtë konsiderojnë se Qeveria e mban përgjegjësinë për zgjidhjen e këtyre problemeve (48 përqind), kurse pastaj pasojnë partitë politike me 33 përqind, përderisa për organizatat ndërkombëtare dhe firmat private janë përcaktuar në mënyrë të barabartë me nga 22 përqind nga të anketuarit. Kjo situatë tregon një paradoks të shoqërisë në Maqedoni. Ndërkaq, të rinjtë konsiderojnë se mund t'ju ndihmojë institucioni në të vilin nuk kanë besim, kurse në vendin e dytë, gjithashtu, është institucioni në të cilin kanë edhe më pak besim se sa në Qeverinë. Kjo e dhënë mund të shërbejë si indikator për sqarimin e faktit që më shumë se 60 përqind të të rinjve janë deklaruar se nuk janë aktiv në jetën shoqërore. Pritja e ndihmës nga dikush në të cilin në shkallë të parë nuk kanë besim, e fuqizon pasivitetin dhe paaktivitetin e të rinjve në Republikën e Maqedonisë. Nëse shikohen për së afërmi rezultatet, do të shohim se faktori i kushtëzimit të qëndrimeve të këtyra, para se gjithash, është mosha.

Të rinjtë midis 26 dhe 30 vjet në masë më të madhe janë ata të cilët konsiderojnë se ndikim më të madh në zgjidhjen e problemeve kanë Qeveria dhe partitë politike. Përderisa ata kanë besim të ulët në Qeverinë dhe partitë politike, sikurse edhe grupet tjera, pjesa më e madhe e të rinjve që janë deklaruar se janë anëtarë të partive politike (21 përqind, në krahasim me 11 dhe 15 përqind te dy grupet tjera) janë në këtë kategori. Nga e gjithë kjo që është thënë deritani, mund ti nxjerrim këto konkluzione:

1. Socializimi politik i të rinjve varet nga mosha e tyre; por edhe se
2. Më të moshuarit, kurse me këtë edhe politikisht më shumë njerëz të ri të socializuar, në masë më të madhe presin ndihmë nga institucionet ndërmjetësuese dhe publike në sistemin politik.

Konstelacioni i këtyre i përgjigjeve të ofruara tregon mundësinë e zhvillimit të "klientelizmit politik" te popullata rinore, e veçanarisht te ata midis 26 dhe 30 vjet. Por, punët nuk janë të paracaktuara të nisen në këtë drejtim, sepse ajo kategori e të rinjve, në masë më të madhe nga të tjerët, i nënvizon edhe firmat private se kanë ndikim të madh në zgjidhjen e problemeve. Por, cilët janë faktorët që i kushtëzojnë këto qëndrime? Grupi i të rinjve midis 26 dhe 30 vjet në masë më të madhe interesohet për ekonomin, respektivisht biznesin, fakt që veçanarisht po rritet me shkallën e arsimimit. Pra, mund të konkludojmë se mosha në konstelacion me socializimin politik i drejton të rinjtë drejt varësisë nga institucionet politike dhe publike në zgjidhjen e problemeve, përderisa mosha në konstelacion me shkallën më të lartë të arsimimit i drejton të rinjtë të kërkojnë zgjidhje në sektorin privat. Edhe në të dy rastet, të rinjtë midis 26 dhe 30 vjet, më shpeshë tregojnë besim në potencialet e veta dhe gatishmëri personalisht të kyçen në zgjidhjen e problemeve. Situata e ngjajshme është edhe në vendet tjera të Ballkanit. Hulumtimet tregojnë se "përderisa shkalla e lartë e arsimimit nuk e zvogëlon rrezikun e të rinjve të

mbetet i paunësuar, megjithatë, po e zvogëlon rrezikun të mbetet i painteresuar dhe i paikurajuar”.¹³

Të anketuarit më të rinjë, prej 18 deri 22 vjet, janë më të pasigurt në kapacitetet e veta dhe janë më pak të gatshëm që të angazhohen në jetën publike. Për ata aktivitetet në jetën publike nuk janë sfidë dhe më së shumti u intereson zbavitja (sipas 30 përqind nga ky grup), përderisa të rinjët prej 22 deri 26 vjet, kurse veçanarisht ata që kanë ose do të kenë arsimim më të lartë, janë në masë më të madhe të sigurt në vete dhe dëshirojnë që të kyçen aktivisht në zgjidhjen e problemeve. Mirëpo, edhe përkundër vullnetit të mirë të të rinjëve, më së shpeshti mungon mbështetja politike nga institucionet e sistemit, si dhe përfshirja në sistemin privat nga ana e firmave. Hulumtimet tregojnë se “kolapsi i sistemit komunist dhe programet e tij për të rinjët krijoi një boshllëk (vakuum) në politikën ndaj të rinjëve”.¹⁴ Deklarativisht, institucionet publike e njohin dobishmërinë nga kyçja e të rinjëve dhe sigurimi i mekanizmave për angazhimin e tyre, për shembull, përmes sigurimit të stazhit volunteeristik. Hulumtimet e realizuara në institucionet publike në disa vende të Ballkanit, tregojnë se mbi 60 përqind të të anketuarëve të punësuar në administratën publike u deklaruan se institucionet e tyre janë të hapur për volunteer të rinjë.¹⁵ Por, në realitet nuk kanë volunteerë për shkak të mungesës së parakushteve formale ose teknike. Studimi i njëjtë tregoi se vetëm 8 përqind nga të anketuarit në administratën publike në Maqedoni kanë deklaruar se kanë kushte të pranojnë volunteerë. Njëherit, madje, punëdhënësit në sektorin privat “kanë motivacione të dobëta të punësojnë të rinjë pa përvojë”.¹⁶ Jointeresimi i institucioneve publike dhe i sektorit privat që ti ndihmojnë të rinjët në studimin e cituar, sqarohen me ekzistimin e praktikave korruptive në vendet ballkanike, mungesën e transparencës në politikën e punësimit, si dhe nepotizëm dhe lidhje familjare.

Organizatat joqeveritare dhe institucionet religjioze kanë përqindje më të ulët në përgjigjet se kanë ndikim të madh në zgjidhjen e problemeve. Edhe pse 44 përqind të të rinjëve kanë besim në Organizatat joqeveritare, qëndrim që është kompatibil me qëndrimet e të rinjëve në Bashkimin Evropian,¹⁷ vetëm një pjesë e vogël konsiderojnë se ato kanë ndikim. Benevolentiteti (Bejovolentiteti) ndaj Organizatave


joqeveritare, por edhe vështrimi kritik në lidhje me kapacitetet e tyre, ndoshta është sqarimi për përqindjen e ulët prej 7,9% të anëtarëve në Organizatat joqeveritare, që është, megjithatë, në vendin e dytë si formë e angazhimit shoqëror. Përqindja e ulët prej vetëm 8,6% të të rinjëve të cilët konsiderojnë se institucionet religjioze nuk kanë ndikim të madh, janë në lidhje me afinitetet sekulare të të rinjëve për dallim nga opinioni i përgjithshëm. Mbetet çështje e hapur, a thua besimi në institucionet religjioze do të ishte më i madh nëse të rinjët konsiderojnë se institucionet e këtilla mund ti zgjidhin problemet e tyre?

Perceptione për marrëdhëniet ndëretnike

Marrëdhëniet ndëretnike tanimë ishin në një pjesë të vogël nën observacion. Më saktë është që të thuhet se perceptonet e ndryshme në vaërsi nga përkatësia etnike u testuan në lidhje me faktorët tjerë të kushtëzimit. Edhe përkundër stabilizimit pas konfliktit të vitit 2001, paradigma për marrëdhëniet ndëretnike është ajo se “bashkësitë më të mëdha etnike (Paqedonët dhe Shqiptarët) kanë pikëpamje të ndryshme, madje të kundërta për marrëdhëniet e tyre të ndërsjellata”.¹⁸ Por, a thua këto konstatime vlejné edhe për më të rinjët dhe cilët faktorë ndikojnë në qëndrimet e tyre? Nëse shihet grafikoni më poshtë, do të shohim se të rinjët konsiderojnë se arsimimi, organizatat ndërkombëtare dhe Organizatat joqeveritare kanë, në masë më të madhe, ndikim pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike.

Edhe atë në lidhje me arsimimin ekziston konsensus te të rinjët, që është vetëm plotësuar me faktin që 42 përqind të larta nga opinioni publik në Maqedoni konsideron se sistemi arsimor nuk kontribuon drejt krijimit të tensioneve etnike.¹⁹ Të rinjët të cilët janë të kyçur ose deri tani ishin të kyçur në sistemin arsimor, e vlerësojnë arsimimin si diçka pozitive për marrëdhëniet ndëretnike. Edhe pse nuk është e qartë a thua mendohet në cilësinë e mësimi ose të aranzhmaneve për mësim dhe studim të grupeve të ndryshme etnike, mbetet qëndrimi benevolent për sistemin arsimor. Arsimimi është simbol i diturisë dhe zbulimit, duke e pranuar si një moment pozitiv, të rinjët dërgojnë mesazh se përmes njohjes njëri me tjetrin përmirësohen marrëdhëniet ndëretnike, por edhe se ata vetë nuk frikësohen që ti

Kush ka ndikim pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike?



Grafikoni 2. Perceptonet e të rinjëve për ndikimin pozitiv të marrëdhënieve ndëretnike (në përqindje)

¹³ La Cava, et al. Young People in South Eastern Europe: From Risk to Empowerment, World Bank: January 2005, faqe 73

¹⁴ Ibid, p. 12

¹⁵ Association for Democratic Prosperity - Zid. Voluntarism and Public Institutions, Podgorica: SEEYN, 2005.

¹⁶ La Cava, et al. Young People in South Eastern Europe: From Risk to Empowerment, World Bank: January 2005, p. 72

¹⁷ Westphal, Sabine. Political Participation of Young Europeans, Vienna: SORA, 2006.

¹⁸ UNDP. Raporti për paralajmrim të hershëm, Shkup, mars 2006, faqe 39

¹⁹ Ibid

mësojnë dallimet që ekzistojnë midis bashkësive etnike.

Konsenzusi që ekziston për sistemin arsimor nuk është aq i dukshëm kur janë në pyetje institucionet ndërkombëtare dhe Organizatat joqeveritare. Poërdërisa për Organizatat joqeveritare Shqiptarët në masë më të madhe kanë mendim se ato kanë ndikim pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike (46,5 përqind), pjesa e madhe e Maqedonëve nuk kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje (25,6%), kurse qëndrimet për ndikim negativ janë të ngjajshme te të dy grupet. Pra, në aspektin e ndikimit të Organizatave joqeveritare, Maqedonët dhe Shqiptarët kanë qëndrimet të ndryshme, por jo të kundërta. Ky fakt me siguri ka të bëjë me atë që pjesa më e madhe nga Organizatat joqeveritare që janë në kontakt me Shqiptarët mirren me problemet ndëretnike, kurse vetëm Maqedonët që jetojnë në mjedise multietnike vijnë në kontakt me këtë lloj të Organizatave joqeveritare. Për këtë ka të bëjë benevolentiteti i Shqiptarëve, por edhe mosnjohja e Maqedonëve. Faktorë tjerë që ndikojnë në përgjigjet janë shkalla e arsimimit dhe vendbanimi. Të rinjtë me arsimim më të lartë, që jetojnë në mjediset urbane, në masë më të madhe besojnë në ndikimin pozitiv të Organizatave joqeveritare, përderisa ata me arsimim më të ulët dhe që jetojnë në mjedise rurale në masë më të vogël janë të bindur në këtë. Besimi në ndikimin pozitiv të Organizatave joqeveritare rritet me joaktivitetin e të anketuarëve. Duket se mundësitë e ulta dhe kualifikimet bashkë me joaktivitetin e të rinjve janë shkaku për pesimizëm ndaj përpjekjeve të individëve të shoqërisë civile të ndërmjetësojnë në marrëdhëniet ndëretnike.

Situata deri diku është inverte kur janë në pyetje organizatat ndërkombëtare. Rezultatet në mënyrë komparative janë prezantuar në tabelën 5 që pason.

Ndërkaq, të rinjtë që jetojnë në mjediset urbane, në masë më të vogël konsiderojnë se organizatat ndërkombëtare kanë ndikim pozitiv në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike, që është në korelacion me arsimimin më të ulët. Përderisa të rinjtë, që jetojnë në mjediset rurale, konsiderojnë në masë më të madhe se organizatat ndërkombëtare kanë ndikim pozitiv, që është në korelacion me arsimimin e lartë që e kanë. Faktor tjetër që e mbështet perceptcionin e ndikimit pozitiv të organizatave ndërkombëtare në marrëdhëniet ndëretnike është mbështetja që të rinjtë e deklarojnë për hyrje në NATO dhe Bashkimin Evropian. Ndërkaq, 46 deri 48 përqind nga ata që do të deklaroheshin pozitivisht me rastin e votimit për hyrje (aderim) në Bashkimin Evropian dhe NATO, konsiderojnë se organizatat ndërkombëtare kanë ndikim pozitiv. Konkludimi që nxirret është se të rinjtë me arsimim të lartë, të cilët përgjithësisht e mbështesin idenë për anëtarësimin në strukturat evro-atlantike, konsiderojnë se organizatat ndërkombëtare kanë ndikim pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike.

Megjithatë, faktori dominant i cili e kushtëzton

perceptcionin për rolin e organizatave ndërkombëtare në marrëdhëniet ndëretnike, është përkatësia etnike e të anketuarëve. Shqiptarët në masë më të madhe konsiderojnë se ndikimi është pozitiv (62,5%), se sa Maqedonët (36,2%), prej të cilëve një e katërta ose 25 përqind, konsiderojnë se ndikimi është negativ, që është rasti me 15 përqind nga Shqiptarët. Në këtë rast, pikëpamjet e Maqedonëve dhe të Shqiptarëve në njëfarë mase janë kundërshtuese. Sikurse që tanimë u theksua, kjo me siguri ka të bëjë me perceptcionet e ndryshme për rolin e organizatave ndërkombëtare në krizën e vitit 2001, por edhe në procesin e implementimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit. Në aspektin e ndikimeve pozitive në marrëdhëniet ndëretnike, ekzistojnë disa ngjajshmëri, por edhe dallime në qëndrimet, si dhe disa kundërshtime.

Por, çka ndodh kur janë në pyetje perceptcionet për ndikimin negativ në marrëdhëniet ndëretnike? Sipas të rinjve, partitë politike në masë më të madhe kanë ndikim negativ në marrëdhëniet ndëretnike. Këtë e konsiderojnë madje 52 përqind nga të anketuarit. Në vendin e dytë janë mediumet, me 38 përqind, dhe shumë afër tyre është Qeveria me 36 përqind. Këto rezultate i rezonojnë qëndrimet e përgjithshme se "qytetarët i konsiderojnë politikanët për përgjegjëse për marrëdhëniet ndëretnike, si dhe se qytetarët konsiderojnë se mediumet janë fajtorë për gjendjen në marrëdhëniet ndëretnike".²⁰

Përveç ndikimit të opinionit më të gjërë, që do të thotë kultura dominante politike i definojnë qëndrimet e opinionit në këtë kuptim, ndikim të rëndësishëm ka edhe përkatësia etnike e të anketuarëve, veçanarisht kur janë në pyetje partitë politike. Partitë politike në më shumë raste kanë përdorur retorikën e mobilizimit etnik për të realizuar ndonjë qëllim të vetë.²¹ Por, përderisa 53 përqind të Maqedonëve konsiderojnë se ato kanë ndikim negativ në marrëdhëniet ndëretnike, 48 përqind të Shqiptarëve e ndajnë këtë qëndrim, ndërsa 32 përqind deklarojnë se ndikimi është pozitiv, që është rasti vetëm me 18 përqind të Maqedonëve. Në aspektin e ndikimit të partive politike në marrëdhëniet ndëretnike, ekzistojnë qëndrime të dukshme të ndryshme dhe të kundërta në lidhje me përkatësinë etnike të të anketuarëve. Raporti i Maqedonëve dhe Shqiptarëve që janë deklaruar se janë anëtarë të partive politike është pothuajse i njëjtë, kështu që sqarimi duhet kërkuar në mënyrën në të cilën të rinjtë Shqiptarë dhe Maqedonë i përfjetojnë partitë politike, si dhe vlerat që ua mëveshin.

Duke i lënë anësh qëndrimet e ndryshme, në lidhje me bindjen në ndikimin negativ që e kanë mediumet dhe Qeveria në marrëdhëniet ndëretnike, pothuajse se edhe nuk ekzistojnë dallime të mëdha në përgjigjet në lidhje me përkatësinë etnike të të anketuarëve, ose faktorët tjerë të ndikimit. Duket se tejngopësia mediale, si dhe përdorimi i marrëdhënieve ndëretnike nga ana e Qeverisë si prizëm nëpër të cilën reflektohen marrëveshjet koalicionale, por edhe


Ndikim pozitiv	Arsimimi më i ulët	Arsimimi më i lartë	Mesatare	Mjedise urbane	Mjedise rurale
OJQ	31	45	37.7	39	36
Organizata ndërkombëtare	40	50	42	39	50

Tabelën 5. Faktorët që e kushtëzojnë perceptcionin pozitiv për ndikimin e Organizatave joqeveritare dhe organizatave ndërkombëtare në marrëdhëniet ndëretnike (në përqindje)

²⁰ UNDP. Raporti për paralajmrim të hershëm, Shkup, mars 2006. faqe 37-38

²¹ Shiko më shumë të Daskalovski, Zhidas, Walking on the edge: Consolidating multi-ethnic Macedonia, Skopje, 2005.

Kush ka ndikim negativ në marrëdhëniet ndëretnike?



Grafikoni 3. Perceptcionet e të rinjëve për ndikimin negativ të marrëdhënieve ndëretnike (në përqindje)

përdorimi në qëllimet ditore politike, e ka çmimin në lidhje me perceptcionin e të rinjëve. Ky problem serioz që e detektojnë edhe analizat tjera të qëndrimeve të opinionit të përgjithshëm, tregon se mediumet dhe institucionet publike politike nuk i kryejnë mjaftë mirë disa nga funksionet e tyre shoqërore. Ndërkaq, në vend që të sigurojnë kohezivitet shoqëror, veçanarisht Qeveria, ata shikohen si agens të ndikimit negativ në marrëdhëniet shoqërore.

Megjithatë, pjesa më e madhe e të rinjëve (47 përqind) konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë përmirësuar në krahasim me vitin e kaluar, kurse më shumë se një e treta (37 përqind) konsiderojnë se të njejtët edhe do të përmirësohen në vitin e ardhshëm. Kurse 10 përqind konsiderojnë se marrëdhëniet etnike janë keqësuar në krahasim me vitin e kaluar, kurse vetëm 8 përqind presin keqësimin në vitin e ardhshëm. Maqedonët në njëfarë mase janë pesimist më të mëdhenjë në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike. 11 përqind nga ata, për dallim nga 6 përqind të Shqiptarëve, konsiderojnë se marrëdhëniet janë keqësuar në krahasim me vitin e kaluar, kurse 10 përqind presin ata të keqësohen edhe në vitin e ardhshëm, që është rast vetëm me 4 përqind të Shqiptarët. Kjo tregon se te një pjesë e vogël të të rinjëve Maqedonë ekziston frikë nga zhvillimi i marrëdhënieve ndëretnike. Megjithatë, është e paqartë a thua kjo frikë është e ndërlidhur me ndonjë ndjenjë të rrezikimit oser është reagim i të drejtave të zmadhuara të bashkësive etnike pas implementimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit.

Ajo që është e qartë është se ekziston një korelacion midis të të anketuarëve të cilët konsiderojnë se Maqedonia është duke shkuar në drejtim të gabuar dhe se marrëdhëniet ndëretnike janë keqësuar në krahasim me vitin e kaluar (17 përqind), respektivisht se ato do të keqësohen vitin e ardhshëm (13 përqind). Edhe pse në pikëpamje të parë duket se pesimistët mbesin pesimist, vlenë të potencohet fakti se këto janë vetëm 30 deri 50 përqind nga përgjigjet e të anketuarëve të cilët konsiderojnë se Maqedonia shon në drejtim të gabuar. Përafërsisht 30 përqind të të rinjëve të cilët konsiderojnë se jemi duke shkuar në drejtim të gabuar, presin përmirësime në marrëdhëniet ndëretnike, respektivisht 35 përqind nga ata kanë deklaruar se marrëdhëniet ndëretnike janë përmirësuar në krahasim me vitin e kaluar. Të rinjët

përgjithësisht konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë përmirësuar, respektivisht se edhe në të ardhmën do të përmirësohen, që është në pajtim të plotë me qëndrimet dhe pritjet e opinionit më të gjërë në Republikën e Maqedonisë.²²

Perceptcione për korrupsionin në Maqedoni

Korrupsioni në Republikën e Maqedonisë paraqet një nga problemet mëflakruese në 16 vitet e kaluara të reformave të tranzicionit dhe angazhimeve për konsolidimin demokratik dhe ekonomik të shtetit. Në këtë kuptim, të dhënat e një numri të madh organizatash ndërkombëtare, midis të cilëve veçohet CPI (Corruption perception index na Transparency International), tregojnë në faktin sipas të cilit qytetarët e Republikës së Maqedonisë në masë të madhe e perceptojnë shtetin e tyre si shumë të korruptuar. Në favor të kësaj flet edhe rangimi i Republikës së Maqedonisë në hulumtimet e realizuara nga ana e kësaj organizate, sipas të cilit Maqedonia gjendet në pjesën e poshtme të tabelës në lidhje me perceptcionin e qytetarëve të saj në lidhje me shkallën e korrupsionit. **Tabelën 6**

Se ky lloj i perceptimit të korrupsionit nuk është më ndryshe te popullata rinore, tregojnë edhe rezultatet nga hulumtimi i realizuar nga ana e Friedrich Ebert Stiftung dhe Institutit për demokraci "Societas Civilis". Të pyetur që ta locojnë problemin më të madh në Maqedoni, korrupsioni e zënë venin e lartë të dytë (26,7% nga të anketuarit janë deklaruar për korrupsionin si problemi më i madh në Republikën e Maqedonisë) dhe rangohet menjëherë pas papunsisë (papunësia është problemi më i madh për 44,8% të popullatës). Distribuimi i barabart i perceptcionit korruptiv tregën atë se te njerëzit e ri në Maqedoni ekziston **konsensus i përgjithshëm** rreth kësaj çështjeje pa dallim gjinie, përkatësie etnike, vendbanimin, arsimimin ose profesionin.

Ky nuk do të ishte faktor aq shqetësues në korrupsionin pamëdyshje nuk perceptohet si **faktor definitivisht determinues** apropos gjendjes së dobët ekonomike në të cilën gjendet Republika e Maqedonisë. Të pyetur që ti rangojnë shkaqet për zhvillimin e ngadalsuar ekonomik të Republikës së Maqedonisë, popullata rinore thekson dy probleme si kryesor në këtë kontekst: korrupsionin dhe menaxhimin e dobët nga ana e Qeverisë.

²² UNDP. Raporti për paralajmërimin e hershëm, Shkup, mars 2006. faqe 32

Viti i hulumtimit	2003	2004	2005
Corruption perception index score (CPI score)	2.3	2.7	2.7
Rangimi i Republikës së Maqedonisë	108	99	104
Numri total i shteteve të ranguar	133	145	158

Tabelën 6. CPI score i Republikës së Maqedonisë në periudhën e viteve 2003-2005²³

Korrupsioni si faktor hendikepues për ekonominë është problem shumë i rëndësishëm për 72,4% nga të anketuarit, kurse problem i rëndësishëm për 21,1% nga ata. Kjo bën në dijeni përqindje kolosale prej 93,5% të të respondentëve të rinjë të cilët konsiderojnë se korrupsioni tanimë vite me radhë po e shkatërron ekonominë e Republikës së Maqedonisë dhe si i këllë është i pranishëm dhe përgjegjës për rritjen e ngadalshme ekonomike.

Ajo që është interesante të potencohet në lidhje me statistikën e lartpërmendura është edhe **koincidimi** i tërësishëm në lidhje me dy faktorët më përgjegjës për rritjen e ngadalshme ekonomike në perceptimet e njerëzve të rinjë. Ndërkaq, menaxhimi i keq nga ana e Qeverisë është faktor shumë i rëndësishëm për 72,4% nga të anketuarit. Kurse faktor i rëndësishëm për 21,4% nga ata (93,8% në përgjithësi). Kjo kohëzgjatje e frikësuese midis joefikasitetit të Qeverisë dhe korrupsionit (93,5%) mund të indicon vetëm në një diçka: njerëzit e ri në Maqedoni korrupsionin në shkallë më të madhe e llocojnë në organet më të larta të pushtetit dhe me këtë i konsiderojnë si më përgjegjës për rritjen e ngadalshme ekonomike, por edhe përgjegjës për gjendjen me përfaqësimin e korrupsionit, që në mënyrë fenomenologjike qartasi është duke e shoqëruar një formular të oktroruar të reflektimit (top to bottom).

Njerëzit e rinjë në Maqedoni e perceptojnë korrupsionin si problem i cili është locuar në mënyrë të saktë në organe të caktuara shtetërore. Në këtë kontekst ata shumë pak inklinojnë në lidhje me mesatarën nacionale në kuptimin e popullatës së caktuar specifike komparuar me

qëndrimet e gjeneralizuara të popullatës në Republikën e Maqedonisë, që në periudhën e fundit arrijnë vlera kulminante (duke përfunduar me marsin e vitit 2006, sipas të dhënave të United Nations Development Programme - Maqedoni).²⁴ Komparimi në këtë kuptim është shumë indikativ edhe në lidhje me veçimin e organeve më të korruptuara të pushtetit ku mesatarja nacionale dhe Youth Aspiration Project indikojnë pothuajse situatë identike.

Është shumë e qartë se **inklinacionet** të popullata e përgjithshme dhe të njerëzit e rinjë janë të vogëla, kurse rangimi i institucioneve më të korruptuara është i ngajshëm. Te të rinjë ky rangim prej institucioneve më të korruptuara deri te institucione më pak të korruptuara është sipas kësaj radhe: ministrinë, gjyqësia, shëndetësia, policia, arsimimi, vetëqeverisja lokale, parlamenti. Te popullata e përgjithshme rangimi i njerëzit është si vijon: ministrinë, doganat, gjyqësia, shëndetësia, parlamenti, policia, arsimimi. Me dallime të vogëla, është shumë e qartë se ministrinë dhe gjyqësia në të dy rastet e mbajnë primatin jo të popullarizuar të institucioneve më të korruptuara. **Tabelën 7.**

Edhe pse po nënvizohet si problem i qartë destruktiv, hulumtimi në suazat hulumtimi për pritjet e të rinjeve tregon një dimension tjetër shqetësues të punëve. Ndërkaq, çështja e marrjes dhe dhënies së rryshfetit të popullata rinore prej 18 deri 30 vjet është më shumë e përfaqësuar në krahasim me mesatarën nacionale. Sikurse që tregojnë rezultatet, 37,9% të larta të të rinjëve kanë qenë dëshmitarë të marrjes ose dhënies së rryshfetit ose drejtpërdrejt u janë kërkuar

	IOM- përqindje e njerëzve të rinjë që janë deklaruar se ekziston korrupsioni në:	Raporti për paralajmrimin e hershëm- UNDP ²⁵ Përqindje e të anketuarëve që janë deklaruar se ekziston korrupsioni në:
Ministrinë	89,7	88,7
Parlamenti	80,5	83,9
Policia	84	79,2
Gjyqësia	89,6	87,8
Shëndetësia	88,3	84
Arsimimi	82,9	77,3
Vetëqeverisja lokale	81,2	/
Dogana	/	88,2

Tabelën 7. Analizë komparative e perceptimeve të njerëzve të ri në lidhje me korrupsionin në organet shtetërore në krahasim me mesatarën nacionale

²³ Burimi: Transparency International

²⁴ Kjo situatë e rritjes së masës perceptivë apropos korrupsionit në shtet e vërteton edhe rënia e Republikës së Maqedonisë në rang-listën e Transparency International për 5 vende. Shiko tabelën 1.

²⁵ Të dhënat janë marr nga Raporti për paralajmrimin e hershëm të UNDP-së (mars 2006) të arritshme në www.ewr.org.mk.

kundërshtërbime për kryerjen e ndonjë pune të caktuar e cila u takon në mënyrë ligjore.²⁶ Kjo tregon se **njerëzit e ri më shpeshë ballafaqohen me praktika korruptive**, me siguri për shkak të shkallës së aktivitetit social të këtij grupi specifik, që gjithsesi shqetëson dhe krijon njejnën e perpetuacionit të praktikave negative dhe transferin e tyre nga më të moshuarit drejt më të rinjëve.

Se **kultura e korrupsionit** po perpetuohet dhe bartet si formë tradicionale e sjelljes në Republikën e Maqedonisë flet edhe fakti se 23,1% të të rinjëve të anketuar janë përgjigjur se do të mirreshin rryshfet nëse kanë rastin të njejtin ta bëjnë. Edhe përkundër odiumit të gjithëmbarshëm negativ drejt korrupsionit, që është në nivelin e konsenzusit shoqëror, dhe vetëdijes për ndikimin e tij të dëmshëm mbi ekonominë, pothuajse një e katërta e të rinjëve të anketuar nuk do ta shmangeshin këtë praktikë të dëmshme edhe përkundër të gjithë asaj. Nëse kësaj i shtohet edhe grupi prej 19% të të anketuarëve që nuk kanë patur përgjigje, ose nuk kanë dëshiruar që të përgjigjen në këtë drejtpërdrejt, situata po fiton dimensione demagogjike, që me të vërtetë është fakt i disfavorshëm, duke marr parasysh se bëhet fjalë për grupin e njerëzve të rinjë prej 18 deri 30 vjet. Kjo nuk bën në dijeni vetëm në fuqinë e traditës në bartjen e ekzemplarëve të sjelljes shoqërore, por edhe rrugën pa dalje të pjesës së madhe të njerëzve të rinjë në Maqedoni. Mos të harrojmë se 22,3% të të rinjëve në Maqedoni kushtet vetanake për jetesë i kanë vlerësuar si të këqija ose shumë të këqija, kurse, madje, 87,8% konsiderojnë se situata ekonomike në Maqedoni për momentin është e keqe ose shumë e keqe. Linja e rezistencës më të vogël te një pjesë e popullatës rinore në rrethana të këtilla është sjellje e prituri.

Tërësia e të dhënave në lidhje me praktikat korruptive në Republikën e Maqedonisë flet për nevojën nga një qasje të organizuar koherente për ballafaqimin dhe luftimin e saj, në saje të asaj se qasja e deritanishme është e qartë se nuk është duke dhënë rezultate të dukshme, e veçanarisht te popullata rinore. Përqindja më e madhe e të rinjëve e perceptojnë korrupsionin si pjesë të përditëshmërisë së tyre, por edhe si praktikë potenciale profitabile, kurse për seriozitetin e situatës flet edhe fakti se nuk ekzistojnë dallime në perceptimin e korrupsionit te njerëzit e rinjë të cilët situatën e vetë financiare e kanë vlerësuar si të mirë ose të shkëlqyeshme, në krahasim me (thënë kushtimisht – megjithatë bëhet fjalë për perceptimin individual) shtresat më të varfëra.²⁷ Korrupsioni është problem për zhvillimin ekonomik njëllojë madje edhe për ata që janë në gjendje të mirë ose të shkëlqyeshme që korrupsionin e legjitimon si njërin nga pikat kanceroze të ekonomisë në Maqedoni.

Perceptione për të drejtat e grupeve të caktuara sociale

Shkalla e vetëdijes në lidhje me të drejtat e njeriut dhe të drejtave të grupave margjinale te popullata rinore ishte pjesë e fokusimit të hulumtimi për pritjet e të rinjve-it. Në vazhdimësi të kësaj, hulumtimi tregoi dallime të mëdha në perceptimet e njerëzve të rinjë në lidhje me grupet e ndryshme në shoqëri, duke implikuar qëndrime radikalisht të ndryshme në lidhje me të drejtat e të pesë grupeve të qytetarëve (dhe spektri i të njejtëve) që ishin hulumtuar. Me qëllim që në mënyrë të saktë të vërtetohet qëndrimi i të rinjëve drejt të të drejtave të femrave, bashkësive etnike, popullatës homoseksuale, personave të hendikepuar dhe të varfërve, u ofruan përgjigje që në mënyrë eksplicite e masin aktivitetin social (ose pasivitetin) të të rinjëve në lidhje me praktikizimin e të drejtave të grupeve të lartpërmendur të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë. **Tabelën 8.**

Nga prezantimi tabelar i qëndrimeve të të rinjëve në Maqedoni në lidhje me të drejtat e grupeve të caktuara sociale, është evidentë dallimi në perceptimet e stratumëve të ndryshme shoqërore. Kjo, nga njëra anë, e përcakton fokusin dhe gjërësinë e debatit publik në Republikën e Maqedonisë, i cili qartazi zhvillohet në mënyrë të selektuar në lidhje me segmente të ndryshme sociale (debatit rreth të drejtave të minoriteteve dhe të grave është shumë më i pranishëm në 16 vitet e fundit, se sa të themi – të drejtat e LGBT-popullatës), kurse, nga ana tjetër, tregon në një volumen kolosal të paragjyqimeve në lidhje me disa çështje të caktuara.

Ajo që është evidente është se dimensionin social e të drejtave të njeriut, është një temë shumë e ndijshme për njerëzit e rinjë në Republikën e Maqedonisë. Në këtë kuptim, të drejtat e të varfërve dhe personave të hendikepuar janë të mbështetura pakushtimisht në çdo kuptim, që është sërish në nivelin e konsenzusit te njerëzit e rinjë pa dallim të shenjave demografike të cilit do ofto karakter. 90% dhe 89,2% të larta të të rinjëve të cilët janë deklaruar për rritjen e të drejtave të personave të hendikepuar dhe të varfër, tregon në shkallën e lartë të **solidaritit social**, por, me siguri (veçanarisht nëse preket tema e varfërisë) në **identifikimin** të një pjese të madhe të popullatës rinore me këto grupe (mund të konkludohet se kjo është e indikuar edhe në tërësinë e indikatorëve ekonomik në këtë hulumtim të cilët të rinjët i perceptojnë si negative). Në këtë kuptim, dimensionin i solidaritetit dhe vetëdijes sociale nuk është e rrezikuar te kjo popullatë, që tregon në traditën e gjatë të ekzistimit të shtetit social e cila bartet te të rinjët.

Kjo përshtypje në fillim pozitive, tanimë është sjellë në pikëpyetje në lidhje me të drejtat e popullatës femrore, ku

	Të drejtat duhet të përmirësohen	Kanë të drejta të mjaftueshme	Të drejtat duhet të reduktohen	Nuk di/Nuk ka përgjigje
Të drejtat e grave	50%	40,6%	6,1%	5,3%
Të drejtat e minoriteteve	21,5%	47,4%	25,6%	5,6%
Të drejtat e popullatës homoseksuale	12,6%	22%	49%	16,5%
Të drejtat e të hendikepuarëve	90%	7,4%	0,9%	1,7%
Të drejtat e të varfërve	89,2%	6,3%	1,4%	3%

Tabelën 8. Qëndrimet e të rinjëve në lidhje me të drejtat e grupeve të caktuara sociale

²⁶ Mesatarja nacionale sipas të dhënave të Raportit për paralajmërimin e hershëm të UNDP-së në mars të vitit 2006 është 18,1%.

²⁷ Nga të anketuarit që janë përgjigjur se situata financiare e tyre është e shkëlqyeshme, vetëm 2,2% janë përgjigjur se korrupsioni nuk është aq i rëndësishëm për zhvillimin e dobët ekonomik, kurse asnjëri nuk është përgjigjur se ai është më i rëndësishëm. Te ata që janë deklaruar se situata financiare u është e mirë, përqindjet adekuate janë 2,9% dhe 1,1%.

shkalla e mbështetjes bie në mënyrë rapide. Në këtë rast, mbështetje për rritjen e të drejtave të grave kanë deklaruar gjysma e të anketuarëve, kurse 40,6% nga ata konsiderojnë se gratë kanë të drejta të mjaftueshme. Nëse kësaj i shtohen edhe 6,1% të të rinjëve të cilët konsiderojnë se këto të drejta duhet të reduktohen, fitohet përqindje prej 46,7% të të rinjëve të cilët në rastin më të vogël nuk do të mbështeteshin një aksion afirmativ në lidhje me të drejtat e grave. Kjo tregon një **kapacitet të fuqishëm konzervativ** në lidhje me këtë tematikë, por edhe në ekzistimin e një rezistence pasive ndaj avancimit të rolit të gruas te një pjesë e madhe të popullatës rinore.

Të dhënat e hulumtimit indikojnë edhe një indikator edhe më të paqenësishëm, e ky është **polarizimi i fuqishëm gjinorë** kur bëhet fjalë për të drejtat e grave. Perceptcionet e ndryshme për të drejtat e grave janë fakt në lidhje me perceptcionin gjinorë, duke patur parasysh se njëra palë është e interesuar drejtëpërdrejt. Kështu, vetëm 33% nga të rinjët-meshkuj të moshjës prej 18 deri 30 vjet, konsiderojnë se të drejtat e grave duhet të përmirësohen, kurse kjo përqindje te femrat është 73,4%. 53,7% të larta të të anketuarëve-meshkuj, konsiderojnë se femrat kanë të drejta të mjaftueshme. Kjo përqindje te të anketuarit-femra është vetëm 22,4%. Konkludimi është më shumë se i qartë. Animi drejt shembujve konzervativ të sjelljes është shumë më i shprehur te popullata rinore mashkullore, gjë që indikon role fuqimisht të definuara gjinore në suazat e familjes dhe shoqërisë, por edhe një dozë të paragjyqimeve të trashëguara te kjo popullatë.

Megjithatë, një kapacitet shumë më i shprehur i paragjyqimeve ekziston në lidhje me të drejtat e popullatës homoseksuale në Maqedoni. Nëse në lidhje me të drejtat e grave ekzistonte një rezistencë pasive te një popullatë e caktuar, në lidhje me të drejtat homoseksuale ekziston një **rezistencë aktive** te të anketuarit e rinjë në suazat e këtij hulumtimi. Është evidente se në këtë rast nuk mund të flasim për mbështetje (vetëm 12,6% janë deklaruar për rritjen e të drejtave të popullatës homoseksuale) të të drejtave të personave homoseksuale, kurse rezistenca është më shumë se evidente (22% - kanë të drejta të mjaftueshme). Rezistenca aktive ndaj promovimit të gej-popullatës reflektohet në madje 49% të të anketuarëve që janë deklaruar për reduktimin e të drejtave të popullatës homoseksuale. Edhe pse të anketuarit-femra janë për një nuancë më liberale nga të anketuarit-meshkuj, edhe te popullata femrore rezistenca ndaj rritjes së të drejtave të popullatës homoseksuale është evidente dhe lartë e pranishme.

Këto të dhëna pjesërisht janë në koincidencë, por edhe në konflikt të pjesërishtëm në lidhje me studimin e paradokohëshëm të Asociacionit maqedonas për orientim të lirë seksual (MASSO) që mirret me problemet e LGBT-popullatës²⁸ në Republikën e Maqedonisë. Nga njëra anë, HPR-hulumtimi dhe analiza e realizuar nga ana e MASSO-së, pamëdyshje treguan se te një pjesë e madhe e popullatës tema e homoseksualizmit dhe të drejtat e personave homoseksual, shkaktojnë pakëndëshmëri dhe janë pjesë të një **tabue më të gjërë shoqërore**. Në lidhje me pesë kategoritë e anketuara te HPR-hulumtimi, grupi i atyreve të cilët nuk ka dëshiruar të japin përgjigje ose nuk kanë ditur të përgjigjen, është shumë më e madhe se sa në krahasim me

grupet e tjera të anketuara sociale²⁹ (madje 16,5% nga të anketuarit janë përgjigjur me "nuk di" ose "nuk ka përgjigje"). Nga ana tjetër, parashtrohet pyetje: a është reale vlerësimi i MASSO-së për përfaqësimin procentual prej 10% (200.000 njerëz) të popullatës homoseksuale në situatë të një rezistence serioze ndaj fenomenit të homoseksualizmit dhe promovimit të gej-të drejtave nga ana e popullatës rinore (të cilët sipas definicionit duhet të jenë pjesa më liberale e pasqyrës shoqërore)?

Raporti ndaj të drejtave të bashkësive etnike e reflekton realitetin post-konfliktuoz të Republikës së Maqedonisë dhe te popullata rinore. Edhe pse ekziston ndarje e madhe në lidhje me këtë çështje, është e qartë se korrniza me të cilën definohej të drejtat dhe obligimet të bashkësive më të mëdha etnike – Marrëveshja korrnizë e Ohrit, sillet në pikëpyetje nga një pjesë procentualisht e rëndësishme të të rinjëve në Maqedoni. Ndërkaq, madje 25,6% të anketuarëve të rinjë janë përgjigjur se të drejtat e minoriteteve etnike duhet të reduktohen, përderisa 47,4% janë të kënaqur me gjendjen e të drejtave në këtë sferë. Potencial për aksion afirmativ ekziston te 21,5 përqind të të anketuarëve. Kjo nuk tregon për kërcnimin e marrëdhënieve etnike³⁰ për se, por në pakënaqësinë te një pjesë e popullatës nga rregullat e lojës definuar me Marrëveshjen korrnizë të Ohrit.

Është simptomatik **perceptcioni etnik** në lidhje me këtë çështje nga aspekti i dy bashkësive për nga numri më të mëdha në Maqedoni: Maqedonët etnik dhe Shqiptarët etnik. Dallimet në perceptcionin në lidhje me të drejtat e minoriteteve janë të dukshme qysh në aksionin afirmativ për të cilin janë përcaktuar 60,6% nga Shqiptarët etnik, por vetëm 8,8% nga Maqedonët etnik. Se bashkësitë etnike kanë të drejta të mjaftueshme konsiderojnë 52,4% të Maqedonëve kundruall 30,9% të Shqiptarëve të rinjë. Për aksion restriktiv janë përcaktuar 5,2% të Shqiptarëve kundruall 32,5% të larta të Maqedonëve të rinjë. Kjo qartazi flet për dallimet në perceptcionin të determinuara nga përkatësia ndaj ndonjë grupi të caktuar etnik, por edhe për perceptcionin e problemit të të drejtave të bashkësive etnike të rinjë si situatë e ngadhënjimit dhe disfatës (duke përfshirë edhe Marrëveshjen korrnizë të Ohrit).

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione:

- Pjesa më e madhe e të rinjëve në Republikën e Maqedonisë konsiderojnë se kanë kushte mesatare të jetës, me pritje se në të ardhmën kushtet e njejta do të përmirësohen. Skeptik në lidhje me ardhmërinë e vetë janë të rinjët që kanë kushte më të këqija të jetës.
- Pjesa më e madhe e të rinjëve në Republikën e Maqedonisë. Më shumë se 60 përqind, nuk kanë asnjë angazhim shoqëror dhe janë krejtësisht letargjik. Nga ata që janë aktiv, pjesa më e madhe janë anëtarë të partive politike, pjesa më e vogël janë anëtarë të organizatave joqeveritare dhe sportive, kurse më së paku janë anëtarë në organizata profesionale.
- Të rinjët në Republikën e Maqedonisë më së shumti

²⁸ Bëhet fjalë për studimin: „Identifikimi i LGBT-popullatës në Republikën e Maqedonisë – viti 2004/2005“ e cila mund të shihet në www.mass.org.mk.

²⁹ Veçanarisht duhet të kihet parasysh se kjo çështje nuk nënkupton as minimum të ekspertizës profesionale, por thjeshtë qëndrim personal ndaj një çështje të caktuar.

³⁰ Nuk duhet të lëhet anësh se në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike te të rinjët mbisundon optimizëm. Madhe, 37% konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike do të përmirësohen ose shumë do të përmirësohen vitin e ardhshëm, kurse vetëm 8,8% konsiderojnë se do të keqësohen ose shumë do të keqësohen. 33,5% konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike do të mbeten të njejta.

intersohen për zbatim dhe sport, kurse deri diku edhe për çështje ekonomike, përderisa interes më të vogël kanë për politikën.

- Besim më të madh të rinjët në Republikën e Maqedonisë kanë në bankat dhe në organizatat ndërkombëtare.
- Besim më të vogël të rinjët në Republikën e Maqedonisë kanë në partitë politike dhe në institucionet publike politike (qeveri, parlament, president). Sikurse edhe te të rinjët në Bashkimin Evropian, besimi i vogël në partitë politike dhe institucionet publike politike është në saje të shkallës së arsimimit dhe aktivitetit social.
- Qëndrimet e të rinjëve janë nën një ndikim të fuqishëm të kulturës dominante politike dhe qëndrimet e opinionit të përgjithshëm. Kjo bën në dije se te të rinjët në Republikën e Maqedonisë dominon vetëdija parohiale politike. Por, të rinjët në Republikën e Maqedonisë janë edhe pasiv në lidhje me ngjarjet publike, nuk janë militant dhe në masë të madhe janë sekular.
- Të rinjët Shqiptarë kanë besim më të lartë në institucionet ndërkombëtare dhe religjioze. Të rinjët Maqedonë kanë besim më të lartë në Armatën e Republikës së Maqedonisë, përderisa qëndrimet ndaj institucioneve tjera, politike ose jo, janë pa ndonjë dallim të madh.
- Sipas të rinjëve në Republikën e Maqedonisë, Qeveria dhe partitë politike kanë ndikim më të madh në zgjidhjen e problemeve. Në konstelacion me konkluzionet tjera, kjo tregon se te të rinjët po zhvillohet një klientelizëm politik.
- Edhe pse kanë besim dukshëm të lartë në Organizatat joqeveritare dhe institucionet religjioze, një pjesë shumë e vogël të të rinjëve presin ndihmë konkrete prej tyre.
- Vetëinicijativa dhe besimi në kapacitetet personale varet nga shkalla e arsimimit që të rinjët e kanë.
- Pjesa më e madhe e të rinjëve në Republikën e Maqedonisë konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë përmirësuar ose janë të njejta në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu, pjesa më e madhe presin përmirësim vitin e ardhshëm.
- Të rinjët në Republikën e Maqedonisë, pa dallim të përkatësisë etnike, konsiderojnë se arsimimi ka ndikim më pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike. Të rinjët Shqiptarë, gjithashtu, konsiderojnë se ndikim pozitiv kanë edhe organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare.
- Sipas të rinjëve në Republikën e Maqedonisë, partitë politike, mediumet dhe Qeveria kanë ndikim negativ në marrëdhëniet ndëretnike. Eksploatimi politik dhe medial i marrëdhënieve ndëretnike krijon odium negativ te të rinjët.

- Korrupsioni në Republikën e Maqedonisë perceptohet si njëri nga problemet më prioritare. Te të rinjët ekziston konsensus i përgjithshëm rreth kësaj çështjeje.
- Të rinjët pamëdyshje konsiderojnë se korrupsioni është njëri nga faktorët më përgjegjës për gjendjen e dobët ekonomike në të cilën gjendet Republika e Maqedonisë.
- Edhe përkundër perceptcionit negativ ndaj korrupsionit te një pjesë e madhe e të rinjëve, kultura e sjelljes korruptive trajtohet si mënyrë tërheqëse e sjelljes.
- Në Republikën e Maqedonisë dimensionin i solidaritetit social ndaj personave të hendikepuar, si dhe ndaj personave të varfërë është i pranishëm në masë të madhe midis popullatës rinore.
- Te popullata rinore (veçanarisht te ajo mashkullore) ekziston rrezistencë pasive ndaj përmirësimit të të drejtave të grave.
- Të drejtat e popullatës homoseksuale në Republikën e Maqedonisë hasin në një rrezistencë aktive te të rinjët, gjë që tregon në ekzistimin e tabusë sociale te një pjesë e madhe nga ky grup I moshës.
- Të drejtat e minoriteteve ende rezultojnë me një perceptcion joobjektiv dhe të anshëm te të rinjët në varësi nga përkatësia ndaj ndonjë grupi të caktuar etnik.
- Të rinjët në Republikën e Maqedonisë tregojnë një kapacitet të fuqishëm konzervativ në lidhje me trajtimin e grupeve të ndryshme sociale.


Rekomandime:

- Të krijohen kushte për një angazhim më të madh shoqëror të të rinjëve, para se gjithash, në institucionet publike dhe në shoqatat profesionale, përmes sigurimit të stazhit volonteristik.
- Të promovohet nevoja dhe dobia e kycjes të të rinjëve në jetën shoqërore nga ana e institucioneve publike, por edhe të organizatave joqeveritare që mirren me çështje rinore.
- Të krijohen mekanizma për edukimin e të rinjëve për institucionet publike politike dhe interakcioni me ata. Përveç temave arsimore për institucionet publike, në arsimimin formal ose joformal në Republikën e Maqedonisë, të njejtit dë të munden një ditë në vit të hapen për vizita nga ana e të rinjëve.
- Të krijohen instrumente për paraqitjen dhe krijimin e qëndrimeve rinore që do të jenë të arritshme deri te opinioni më i gjërë në Republikën e Maqedonisë, para se gjithash, nga organizatat rinore, por edhe nga ana e institucioneve tjera që kanë interes nga kjo (për shembull: të rinjët e partive politike).
- Të sigurohet një mbështetje më e madhe publike nga bankat dhe organizatat ndërkombëtare për nxitjen për

angazhim nga ana e të rinjëve.

- Të krijohen mekanizma për angazhim, para se gjithash, ekonomike, të të rinjëve që kanë shkallë më të lartë të arsimimit.
- Qeveria dhe partitë politike ta ndalin praktikën e punësimeve partiake në administratën publike.
- Të përfshihen në sistemin arsimor tema të cilat do ti trajtojnë marrëdhëniet ndëretnike. Pa dallim a thua temat e këtilla do të jenë pjesë e arsimimit formal ose joformal, duhet të implementohen në tërë teritorinë e Republikës së Maqedonisë, e jo të jenë të implementuar kryesisht vetëm në mjediset multietnike.
- Programet dhe projektet që janë të dedikuara për ti përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike, duhet të jenë aktive edhe jashtë mjedisve multietnike.
- Partitë politike dhe institucionet publike politike mos ti trajtojnë marrëdhëniet ndëretnike në politikën e tyre të përditëshme dhe ta ndalin praktikën e mobilizimit etnik për mbështetje politike.
- Mediumet duhet ta vendosin theksin e informacioneve në faktet dhe argumentet, para se të fokusohen në përkatësinë etnike. Etnizimi i ngjarjeve me çdo çmim, para se gjithash, sjell perceptione negative ndaj medimeve, kurse gjithashtu është e dëmshme edhe për marrëdhëniet ndëretnike.
- Të inicohet një fushatë e gjithëmbarshme për ballafaqimin me korrupsionin në të gjitha nivelet, kurse veçanarisht në nivel të zgjidhjeve sistemore që lëjnë hapsirë për praktika të këtij karakteri.
- Të fillohet me një fushatë publike për luftë kundër korrupsionit me theks të veçant në pasojat që ai i lënë mbi ekonominë e shtetit.
- Të inicohet një debat i fuqizuar publik rreth çështjeve të të drejtave gjinore, si dhe të drejtave e popullatës homoseksuale.
- Të fuqizohen angazhimet rreth ndryshimit të perceptonit të të drejtave minoritare, duke e nxjerrë nga konteksti i "fitimtarëve" dhe "humbësve".
- Të caktohen dhe analizohen shkaqet të cilët sjellin deri te krijimi i një kapaciteti të fuqishëm konzervativ të popullata rinore në Maqedoni.

MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE





Duke patur parasysh konstelacionin kompleks të marrëdhënieve domicile dhe rajonale, në suazat e të cilëve funksionon sistemi shoqëror në Maqedonim është e domosdoshme që të potencohet roli dhe rëndësia e ndikimit të faktorëve ndërkombëtar mbi Republikën e Maqedonisë. Këtu, pamëdyshje prioritete janë dy proceset paralele të integritimit në Bashkimin Evropian dhe NATO, që praktikisht në mënyrë afatgjate do të jenë një nga faktorët më të rëndësishëm në zhvillimin politiko-ekonomik të shtetit dhe pozitën e saj të ardhshme në skenën ndërkombëtare. Këto dy procese paraqesin interesë kulminant shtetëror dhe janë një nga shtyllat kryesore të debatit rreth ardhmërisë të të rinjëve në Maqedoni. Sëkëndejm, paraqitet edhe nevoja nga një hulumtimi më të detajuar të perceptimeve dhe pritjet e popullatës rinore drejt ardhmërisë evro-atlantike të Maqedonisë. Në vazhdimësi të kësaj, paraqitet edhe nevoja nga kanalizimi i perceptimeve dhe për punën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si edhe një faktor i rëndësishëm ndërkombëtar.

Perceptime mbi procesin e përafritimit drejt Bashkimit Evropian

Trendi i lejimit të lartë të procesit të përafritimit të Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian, i cili transponohet në një mbështetje të madhe procentuale te popullata e përgjithshme gjatë dy viteve të fundit është indikativ edhe te popullata rinore. Kështu, 73,8% të larta të qytetarëve të moshës prej 18 deri 30 vjet, do të votonin në referendumin për anëtarësimin e Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Mirëpo, edhe përkundër asaj që aspiratat e të rinjëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian³¹ nuk mund të vëhen në pikëpyetje, megjithatë mund të potencohet përqindje më e vogël e mbështetjes te ky grup në krahasim me popullatën e përgjithshme në Maqedoni. Sëkëndejm, 87,2% të qytetarëve nga popullata e përgjithshme në Maqedoni do të votonin për anëtarësim në Bashkimin Evropian, poqese javën e ardhshme do të mbahet referendumi për aderimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, që paraqet pothuajse 14,5% inklinacion më të lartë drejt Bashkimit Evropian kundruall afiliacionit më të ulët te të rinjët. **Tabelën 9**

Përveç deklinacionit të trendit të mbështetjes së lartë për anëtarësi në Bashkimin Evropian, që ishte e dukshme te të gjitha vendet-kandidatë për anëtarësi në periudhën pas fitimit të statusit të kandidatit, në rastin e Maqedonisë imponohen edhe faktorë më konkret që nuk janë të lidhur drejtpërdrejt me ndikimin e procesit reformues dhe problemet që dalin nga ai. Rrënie e pritur e evro-euforisë që e shënoi kulminacionin e vetë në dy momentet më të rëndësishme, respektivisht paraqitjen e aplikimit për anëtarësi dhe shpalljen e statusit të kandidatit, në njëfarë mënyre është nënvizuar me dy procese paralele që po zhvillohen në Maqedoni dhe në Bashkimin Evropian.

Nga njëra anë, është reale të pritet procesi zgjedhor, që është temë qendrore shoqërore në gjysmën e parë të vitit 2006, që të jetë mbi pjesën tekniko-administrative të procesit të integritimit evropian. Në njëfarë mënyre, edhe përkundër asaj që përafritimi drejt Bashkimit Evropian është një nga temat më të rëndësishme gjatë fushatës, megjithatë, ajo luan rol sekundar kundruall rëndësisë të fitores zgjedhore.

Nga ana tjetër, me rëndësi të jashtëzakonshme është edhe gjendja në vetë Bashkimin Evropian dhe debati i tij intern rreth procesit të zgjerimit dhe fuqisë absorbuese të Unionit. Duke patur parasysh mbulimin e gjërë medial të kësaj çështjeje, me çrast nuk mungojnë edhe pikëpamjet pesimiste të aktorëve të caktuar apropos ardhmërisë evropiane të Maqedonisë, krejtësisht reale është që të pritet edhe një impakt i caktuar mbi perceptimet e të rinjëve në Maqedoni, që marr në mënyrë të përgjithshme, janë edhe më të goditurë nga problemet që dalin nga marrëdhëniet midis Bashkimit Evropian dhe Maqedonisë.

Fund-fundi, tendencat e lartëpërmendura në kurrfarë rasti nuk duhet të sqarohen si zvogëlim serioz i mbështetjes të anëtarësimin të Maqedonisë në Bashkimin Evropian te popullata rinore. Ndërkaq, shkalla e mbështetjes është dukshëm e lartë, kurse fakti që vetëm 5,8% të të rinjëve janë kundër, sido që të jetë shkon në favor të kësaj teze. Ndërkaq, kjo mbështetje e lartë dominon nëpër të gjitha kategoritë demografike pa ndonjë fluktacion të rëndësishëm procentual. Në mbështetje të interpretimit të këtyre shkojnë edhe të dhënat nëse në mënyrë statistikore krostabulohen të dhënat me gjendjen financiare të të anketuarëve. Këtu, vërrehet mbështetje e lartë te të gjitha shtresat në shoqëri me çrast të anketuarit më të pasur janë me perceptim më pozitiv (77,8% te ata me gjendje të shkëlqyeshme financiare dhe 73,1% te ata me gjendje të mirë financiare). Diçka më skeptik janë shtresat më të varfëra ku 12,1% do të deklaroheshin kundër anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Megjithatë, edhe te kjo kategori mbështetja lëviz në suazat e mesatares së përgjithshme.

Në fund, nëse bëhet një komparim i perceptimeve të të rinjëve në Maqedoni me atë të të rinjëve në Bashkimin Evropian vis-a-vis mbështetja drejt Bashkimit Evropian, indikative janë përqindjet më të larta të mbështetjes te të rinjët Maqedonë. Ndërkaq, kundruall mbështetjes të anëtarësimin të Maqedonisë në Bashkimin Evropian, që në përqindje është deklaruar me 73,8%, 63% të të rinjëve në Bashkimin Evropian konsiderojnë se anëtarësimi i vendit të tyre në Bashkimin Evropian është punë e mirë.³² **Tabelën 10**

Perceptimet për ndikimin e BE mbi parametrat kryesor shoqëror

Nëse shikohen qëndrimet e popullatës rinore në Maqedoni në lidhje me ndikimin e procesit të integritimit evropian mbi disa faktorë të rëndësishëm shoqëror, është e

	Popullata e përgjithshme (hulumtimi i IDSCS, prill 2006)	Popullata rinore (IOM)
Poqese javën e ardhshme do të mbahet referendumi për pranimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, si do të votoni (% pozitivisht)	87,2%	73,8%

Tabelën 9

³¹ Истражување спроведено од Институтот за демократија "Societas Civilis" - Скопје за потребите на Секретаријатот за европски прашања, април 2006

³² Në "Youth takes the floor"-Young Europeans' concerns and expectations as to the development of the European Union (Background note based on relevant findings from Eurobarometer data) Publication: December 2005, faqe 2

	Popullata rinore në BE (Eurobarometer, dhjetor 2005)	Popullata rinore (IOM)
Mbështetje e anëtarësimit në BE	63%	73,8%

Tabelën 10

qartë teza se Bashkimi Evropian dhe procesi i aderimit janë perceptuar si katalizatorë jashtëzakonisht të rëndësishëm të problemeve të caktuara në platformën socio-politike të Maqedonisë.

Mbështetja e komponentës ekonomike është krejtësisht e qartë me çrast tre parametrat kryesor për rritje ekonomike: zhvillimi ekonomik, investimet e drejtëpërdrejta të huaja dhe zhvillimi teknologjik, janë përfitimi kryesor nga procesi i integritimit evropian për tetë nga dhjetë të rinjë në Maqedoni. Nëse integrimi i Maqedonisë në Bashkimin Evropian zhvillohet me tempo stabil, pritjet e këtyra duhet të perceptohen realisht dhe paralelisht me pritjet e gjithëmbarshme ekonomike, duke patur parasysh se 87,1% nga ata të anketuarit të cilët konsiderojnë se procesi i evrointegritimit do të ketë ndikim pozitiv mbi zhvillimin ekonomik, njëherit janë të bindur se situata ekonomike gjatë disa viteve të ardhshme do të jetë më e mirë. Në mënyrë të plotësuar, 41,7% të të rinjëve konsiderojnë se kushtet e tyre të jetesës deri diku do të përmirësohen. Mirëpo, perceptioni i këtyre nuk duhet të shkaktoj konkluzione të përsheptuara, pasi që këto të dhëna nuk do të thot se pritjet për përmirësimin e situatës ekonomike janë edhe arsye për pritjen e standardit jetësor i cili është në pajtim me standardet e dëshiruara të popullatës rinore. E dhëna se 74,7% të të rinjëve në Maqedoni mendojnë për mundësinë e emigrimit, me çrast 78,3% do të emigronin për shkak të arsyeve financiare, tregon në një qëndrim të rezervuar.

Tabelën 11.

Nga ana tjetër, 76,5% të të rinjëve në Bashkimin Evropian shohin një faktor shumë stabilizues, duke patur parasysh rolin e Bashkimit Evropian jo vetëm në shoqërinë e Maqedonisë, por edhe në një kontekst më të gjërë rajonal. Perceptioni i këtyre është njëlloj e distribuar nëpër të gjitha kategori demografike, duke përfshirë edhe ate etnike. Për

dallim nga perceptioni për NATO,³⁴ Bashkimi Evropian si faktor i sigurisë dhe stabilitetit, gëzon mbështetje të njëjtë edhe te të dy bashkësitë më të mëdha etnike, Maqedonët dhe Shqiptarët. Është e qartë njohja dhe roli që Bashkimi Evropian mund ta luaj në mbindërtimin e vetëdijes demokratike, prandaj, kështu, 75% të të rinjëve në Maqedoni në Bashkimin Evropian shikojnë një faktor pozitiv i cili do të kontribuoj në zhvillimin e të drejtave të njeriut në Maqedoni. Praktikisht, pikëpamja e këtyre në njërin nga kriteret më të rëndësishme politike, mund në mënyrë sugjестive të ndihmoj në tejkalimin e problemit me odium negativ në lidhje me të drejtat e disa grupeve shoqërore.³⁵

Analiza komparative e perceptimeve të të rinjëve krahasuar me perceptimet e popullatës së gjithëmbarshme, tregon një optimizëm më të madh te popullata rinore, veçanërisht kur është fjala për rolin pozitiv të procesit integruar mbi zhvillimin ekonomik dhe investimet e drejtëpërdrejta të jashtme. Trendi i këtyre është krejtësisht në pajtim me tendencat te të rinjëve në vetë Bashkimin Evropian apropos rëndësisë së procesit integruar për fuqinë dhe zhvillimin e ekonomisë. Kështu, 68% të të rinjëve në Bashkimin Evropian (kundruall 56% të popullatës së gjithëmbarshme) janë të disponuar në mënyrë optimiste për perspektivat e zhvillimit ekonomik. Ky optimizëm është edhe më i madh te popullata rinore e cila vjen nga 10 shtete-anëtarë të ri (75%).³⁶ Te parametrat tjerë, ekziston pothuajse percepton identik midis të të rinjëve dhe popullatës së gjithëmbarshme në Maqedoni. Disparitet i vogël në qëndrimet është i pranishëm vetëm te ndikimi i procesit të integritimit evropian mbi politikën vendase, që tregon perceptonin i cili nuk sheh varësi të madhe të skenës politike vendase nga presioni i procesit të përafritimit të Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian. Ndërkaq, duke patur parasysh trendin e rënies te popullata e gjithëmbarshme

Me integrimin e Maqedonisë në BE çfarë do të jetë ndikimi mbi punët, si vijon?	IOM - Përqindje e të rinjëve që janë përgjigjur pozitivisht	Hulumtimi i IDSCS ³³ % e të anketuarëve që janë përgjigjur pozitivisht
Zhvillimi ekonomik	82,7%	75,7%
Investime të drejtëpërdrejta të jashtme	85,1%	72,1%
Politika vendase	58,9%	65%
Stabiliteti	76,5%	75%
Të drejtat e njeriut	75,1%	76,3%
Zhvillimi teknologjik	77,4%	77,2%
Vlera nacionale / Identiteti	56,9%	/

Tabelën 11

³³ Hulumtimi i realizuar nga Instituti për demokraci "Societas Civilis"-Shkup, për nevojat e Sekretariatit për çështje evropiane, prill viti 2006.

³⁴ Shiko faqet 28-29

³⁵ Shiko faqen 20

³⁶ Në "Youth takes the floor"-Young Europeans' concerns and expectations as to the development of the European Union (Background note based on relevant findings from Eurobarometer data) Publication: December 2005, faqe 9

(me përjashtim të periudhës menjëhere pas mendimit pozitiv të Komisionit Evropian),³⁷ mund të pritet edhe zvogëlim i mëtejshëm i perceptcionit pozitiv rreth ndikimit të procesit evro-integruës mbi politikën vendase.

Në fund, fokusi i këtij hulumtimi ishte drejtuar edhe ndaj perceptioneve të rinjëve në lidhje me ndikimin e përafrimit drejt Bashkimit Evropian mbi identitetin e tyre dhe vlerat nacionale të Maqedonisë. Është interesant, kjo është njëra nga përpjekjet pioniere që të hulumtohen perceptcionet e rinjëve në lidhje me këtë çështje, e cila, madje, paraqet temë aktuale në suazat e debatit rreth ardhmërisë së Evropës. Mesatarisht, gjysma e të rinjëve në Maqedoni konsiderojnë se procesi evro-integruës do të ketë ndikim pozitiv mbi vlerat tradicionale dhe identitetin nacional. Nga ana tjetër, 12,4% llogarisin në ndikimin negativ. Kjo pasqyrë tregon një ndarje të caktuar, me çrast ndikimi pozitiv mbi identitetin dhe vlerat më shumë duhet të interpretohet si materje kohezive drejtuar drejt përfundimit të identitetit përmes identifikimit me përkatësinë Evropiane, mirëpo jo edhe pranimi i parësishëm të identitetit evropian në llogari të identitetit nacional. Si shtesë të kësaj teze shkojnë edhe të dhënat nga vetë Bashkimi Evropian, ku vetëm 3% të rinjëve ndjehen vetëm si Evropian, me çrast ky numër te popullata rinore që vjen nga dhjetë shtete-anëtare të reja, është edhe më e vogël dhe është vetëm 1%.³⁸ Nga ana tjetër, evropiane nga ate nacionale e ndajnë 58% të rinjëve që është tendencë e ngjajshme me perceptcionin e impaktit pozitiv të procesit evro-integruës mbi identitetin dhe vlerat tradicionale të rinjëve të Maqedonisë. Me këtë rast, duhet theksuar se ndikimi pozitiv i idesë evropiane mbi identitetin dhe vlerat vetanake është më shumë e anticipuar te të rinjtë e bashkësisë shqiptare (67,3%), kundruall mbështetjes relativisht më të vogël te të rinjtë e bashkësisë maqedone (54,1%). Prosesi eventual i vazhdueshëm i informimit të rinjëve rreth mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Bashkimit Evropian, si dhe rreth vetë vlerave të ndërlidhura me idenë evropiane, fund-fundi do të rezultonte me një proces të përforcuar dhe të zmadhuar të ndërtimit të identitetit evropian.

Pritjet personale nga procesi i përafrimit të Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian, gjithashtu, janë shumë të larta. Kështu, 72% të rinjëve në shtet konsiderojnë se ky proces do të sigurojë më shumë mundësi

në proekcionin e tyre personal për të ardhmen. 15%, madje, konsiderojnë se nuk do të ketë ndikim mbi karrierën e tyre të mëtejshme. Një përqindje e këtillë e lartë tregon një afilicacion të fuqishëm personal me procesin e integritimit evropian i cili imponon edhe pritje pozitive për mundësitë që ky proces i hapë. Me këtë rast, 44,6% të anketuarëve të cilët konsiderojnë se kushtet e tyre të jetës do të përmirësohen në të ardhmen, përmirësimin e këtillë e shikojnë si pasojë e ndikimit të aderimit drejt Bashkimit Evropian mbi sigurimin e më shumë mundësive për të rinjtë.

Vlrësimet e të rinjëve në lidhje me kornizën reale kohore në të cilën Maqedonia do të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, në një masë të caktuar janë në pajtim me parashikimet e ekspertëve. Sëkëndejmi, 33,2% të anketuarëve të rinjë në Maqedoni konsiderojnë se Maqedonia do të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian në periudhën e dhjetë viteve të ardhshme. Përqindje e ngjajshme, 29,4% e shikojnë Maqedoninë në Bashkimin Evropian pas vitit 2016. Nëse bëhet një komparim me perceptcionet e popullatës së gjithëmbarshme për të njëjtën problematikë, mund të shihet një qëndrim më pak optimist dhe ndoshta qëndrim më objektiv i të rinjëve rreth temposë së procesit reformues dhe plotësimit të kriterëve për anëtarësim. Kështu, 26,7% të popullatës së gjithëmbarshme konsideron se Maqedonia do të jetë anëtare e Bashkimit Evropian gjat pesë viteve të ardhshme, që është për 10% inklinacion më i lartë se sa te të anketuarit e rinjë. Nga ana tjetër, një përqindje diçka më e lartë e të anketuarëve të rinjë, konsiderojnë se supozim real është se Maqedonisë do ti duhen më shumë se pesë vjet për anëtarësimin e saj eventual në Bashkimin Evropian.

Në këtë drejtim, indikativ është edhe perceptcionin i të dy grupeve më të mëdha etnike, të Maqedonëve dhe Shqiptarëve. Kështu, te të anketuarit e rinjë të bashkësisë shqiptare, ekziston një optimizëm më i madh viza-vi anëtarësimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian në periudhën deri në vitin 2011 (22,4% te Shqiptarët, kundruall 12,7% te Maqedonët). Nga ana tjetër, numër më i madh i Maqedonëve të rinjë konsiderojnë në anëtarësimin e Maqedonisë në një periudhë më të gjatë se 5 vjet. Kur është fjala për popullatën e gjithëmbarshme, kjo tendencë fiton përmasa edhe më të mëdha.³⁹

Marr në përgjithsi, procesi i integritimit të Republikës

	IOM - Përqindje e të rinjëve që janë deklaruar se Maqedonia do të bëhet anëtare e BE-së:	Raporti për paralajmërimin e hershëm UNDP ⁴⁰ - Përqindje e të anketuarëve që janë deklaruar se Maqedonia do të bëhet anëtare e BE-së:
Gjatë 5 viteve të ardhshme	15,9%	26,7%
Gjatë 10 viteve të ardhshme	33,2%	27,7%
Më shumë se 10 vjet (te EWR 15 vjet)	29,4%	25%
Asnjëherë	11%	13,9%
Nuk ka përgjigje / Nuk di	10,4%	6,4%

Tabelën 12. Parashikime për anëtarësi në BE

³⁷ Nëse bëhet një pasqyrë komparative e hulumtimeve të opinionit publik drejtuar kësaj problematike, vërrehet një rënie e perceptcionit pozitiv ndaj ndikimit të integritimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian mbi politikën vendase. Kështu, në maj të vitit 2004, në pyetjen: "Me integritimin e Maqedonisë në Bashkimin Evropian, çfarë do të jetë ndikimi mbi punët, si vijojnë: politika vendase", 79% janë deklaruar pozitivisht; në dhjetor të vitit 2004, në të njëjtën pyetje pozitivisht janë deklaruar 67,3%, kurse në dhjetor të vitit 2005 mbështetja është rritur në 78%, dhe sërish të bie në 65% më të ulta në prill të vitit 2006. Hulumtime të realizuara nga Instituti për demokraci "Societas Civilis"-Shkup, për nevojat e Sekretariatit për çështje evropiane, maj i vitit 2004, dhjetor i vitit 2005, prill i vitit 2006.

³⁸ Në "Youth takes the floor"-Young Europeans' concerns and expectations as to the development of the European Union (Background note based on relevant findings from Eurobarometer data) Publication: December 2005, faqe 8

³⁹ Kështu, sipas të dhënave nga Raporti për paralajmërimin e hershëm të UNDP-së, (mars i vitit 2006) (që gjenden në www.ewr.org.mk), madje 53,2% të Shqiptarëve kundruall 18,2% të Maqedonëve, konsiderojnë se Maqedonia do të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian në një kornizë kohore prej pesë viteve të ardhshme.

⁴⁰ Të dhënat janë marr nga Raporti për paralajmërimin e hershëm të UNDP-së (mars i vitit 2006) që gjenden në www.ewr.org.mk.

së Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian gëzon një mbështetje shumë të lartë te popullata rinore. Me këtë rast, integrimi evropian perceptohet si faktor shumë i rëndësishëm për përmirësimin e gjendjes në më shumë sfera shoqërore, me çrast theks më i madh vehtet në parametrat ekonomike. Për shumicën e qytetarëve të ri, perspektiva evropiane është perspektivë e mundësive të reja dhe kushte më të mira të jetës. Pritjet për aderimin e Maqedonisë në Bashkimin Evropian janë reale dhe identike me opinionet e ekspertëve. **Tabelën 12**

Një shikim kompozitiv i të gjitha të dhënave nga ky hulumtim tregon perceptcionin e procesit të integritimit evropian si në proces i cili në masë të madhe do të zgjidhë problemet ekzistenciale të të rinjve në Maqedoni. Për dallim nga perceptcionet e të rinjve në Bashkimin Evropian, për të cilin Bashkimi Evropian do të thotë liri e udhëtimit, studimit dhe punës,⁴¹ në rastin e Maqedonisë kihet përshtypje se procesi i integritimit evropian zenë më shumë momentum ekzistencial dhe stabilizues. Me këtë rast, në vetë Bashkimin Evropian besim kanë 57% të popullatës rinore (nga të cilët 21,2% kanë besim të madh, kurse 35,8% kanë besim të pjesërisht). Në njëfarë mënyre shqetëson e dhëna e cila thotë se 21,2% të të rinjve nuk kanë besim në Bashkimin Evropian. Sëkëndejmi del një pabarazi e caktuar e perceptcionit të lartë pozitiv të vetë procesit të përafrimit drejt Bashkimit Evropian dhe relativisht mbështetjes më të dobët që vetë Bashkimi Evropian e gëzon te të rinjtë. Kjo tregon nevojën për një shkallë më të madhe të informimit të të rinjve rreth rolit të Bashkimit Evropian në Maqedoni dhe, para se gjithash, vlerat dhe idetë që ai i përfaqëson.

Perceptcione mbi procesin e përafrimit drejt NATO-së

Anëtarësimi i Maqedonisë në NATO është njëri nga prioritetet më të rëndësishme të jashtme politike me çka pajtohet edhe pjesa më e madhe e popullatës rinore. HPR-hulumtimi tregon një mbështetje të lartë për anëtarësimin të Maqedonisë në NATO, me çrast 70% të të rinjve do të votonin për aderim në NATO në referendumin eventual. Me këtë rast, këtij skenari i kundërshtojnë 9%. Ajo që është indikative, është pothuajse mbështetje e njejtë që e fitojnë proceset paralele të integritimit në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Të gjitha anketimet e deritanishme të popullatës së gjithëmbarshme, kanë treguar mbështetje më të madhe procesit të integritimit evropian. Kjo tregon një rënie të butë të mbështetjes së procesit të integritimit evropian,⁴² por edhe një pozicionim relativisht më të fuqishëm i politikës së përafrimit drejt NATO-së. Ky konstatim fiton edhe më shumë në rëndësi nëse kihet parasysh profilimi dukshëm më i ulët medial i këtij procesi. Këtu duhet të potencohet edhe një korealcion shumë i qenësishëm me kornizën kohore për anëtarësim, me çrast gjasatë për një anëtarësim më të shpejtë në NATO janë relativisht më të mëdha dhe më reale. Nga ana tjetër, trendi i mbështetjes më të lartë të këtij procesi te Shqiptarët etnik është evident edhe në këtë hulumtim, ku 80% të Shqiptarëve do të votonin për aderim në NATO kundruall 64,8% të Maqedonëve. Ky pohim është edhe më evident nëse shikohet përqindja e kundërshtarëve të këtij procesi. Kështu, kundër do të deklaroheshin 10,7% nga Maqedonët, kundruall jashtëzakonisht 3% të ulta të Shqiptarëve.

Mirëpo, analiza e të dhënave për afilacionin drejt NATO-së, si garantues për sigurinë personale të të

anketuarëve, tregon një disperzion më të lartë të përgjigjeve. Edhe përkundër asaj që 62% të të anketuarëve në njëfarë mënyre konsiderojnë se anëtarësimi në NATO do ta rritë sigurinë e tyre, përafërsisht 10% janë fuqimisht të bindur në atë, 24% e ndajnë këtë opinion (mendim), por me një intenzitet diçka më të dobët, përderisa 29% konsiderojnë se NATO-ja do ta rritë sigurinë, por deri në një shkallë të caktuar. Nga ana tjetër, 28,5% kursesi nuk konsiderojnë në NATO-në si faktor apropro sigurisë së tyre personale. Këto numra tregojnë perceptcionin e një situatë stabile në kontekstin rajonal, por edhe në kontekstin vendas. Si plotësim të këtij pohimi shkojnë edhe të dhënat që flasin se 54% të të anketuarëve të cilët konsiderojnë se anëtarësimi në NATO nuk do ta rritë sigurinë e tyre personale dhe 73% plotësues të të anketuarëve të cilët konsiderojnë se anëtarësimi në NATO deri në një shkallë të caktuar do ta rritë sigurinë e tyre, njëherit e mbështesin anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, që do të thotë se anëtarësimi në NATO nuk duhet vetëm e vetëm të lidhet me përmirësimin e sigurisë personale. Njëherit, besimi relativisht i lartë në armatën dhe policinë, gjithashtu, kontribuojnë për një disperzion të këtillet të perceptcioneve. Nga ana tjetër, ngjajshëm sikurse edhe te pyetja paraprake, ekzistojnë perceptcione të ndryshme të të dy bashkësive më të mëdha etnike viza-vi ndikimit të anëtarësimin në NATO mbi sigurinë personale. Kështu, 17,5% të larta të Shqiptarëve (kundruall 7,2% të Maqedonëve) konsiderojnë se anëtarësimi i Maqedonisë në NATO-aleancën në masë të madhe do ta rritë sigurinë e tyre personale. 35% plotësues të Shqiptarëve (kundruall 20,8% të Maqedonëve) janë përgjigjur se anëtarësimi në NATO do ta rritë sigurinë. Vetëm 13,8% të Shqiptarëve nuk besojnë në siguri më të madhe si pasojë e anëtarësimin në NATO. Te Maqedonët ky numër është 32,6%.

Perceptcione mbi rolin e agjensive të Kombeve të Bashkuara

Puna e agjensive të Kombeve të Bashkuara në njëfarë mënyre ka rol të dorës së dytë në krahasim me rolin e Bashkimit Evropian dhe të NATO-së, të cilin mediumet më shumë i eksploatojnë, prandaj, sëkëndejmi bëhet në dijeni që të shikohen perceptcionet mbi këto organe të cilët drejtëpërdrejt mirren me numër të madh të problemeve ekzistenciale në vendbanimet rurale dhe ato urbane. 49,7% të të rinjve në Maqedoni e shikojnë kontributin e agjensive të Kombeve të Bashkuara në zhvillimin e Maqedonisë, përderisa 28% relativisht të larta nuk shikojnë kurrfarë roli specifik të këtyre agjensive. Kjo e dhënë tregon nevojën e një qasjeje pozitive deri te opinionin që do të rezultojë me një shkallë më të lartë të informimit të të rinjve në Maqedoni rreth projekteve të ndryshme që implementohen nga ana e agjensive të Kombeve të Bashkuara.

Mirëpo, nëse analizohen të dhënat që vijnë nga krostabulacioni sipas përkatësisë etnike, vihet deri te konkludimi se puna e agjensive të Kombeve të Bashkuara u është shumë më e afër Shqiptarëve. Kështu, 22,7% të Shqiptarëve (kundruall 6% të Maqedonëve) konsiderojnë se agjensite e Kombeve të Bashkuara në masë të madhe kontribuojnë për zhvillimin e Maqedonisë. Në vazhdim, 44% të Shqiptarëve konsiderojnë se agjensite e Kombeve të Bashkuara deri në një shkallë të caktuar janë faktor në zhvillimin, që rezultojnë me një impakt pozitiv të Kombeve të Bashkuara te pothuajse 67% të popullatës rinore shqiptare në Maqedoni. Nga ana tjetër, kontributi në zhvillimin e

⁴¹ Kështu, për 62% të popullatës rinore në Bashkimin Evropian kjo paraqet liri e udhëtimit, studimit dhe punës. Te të rinjtë e dhjetë shteteve-anëtare të reja, ky perceptcion është edhe më i lartë dhe është 76%. Burimi: "Youth takes the floor"-Young Europeans' concerns and expectations as to the development of the European Union (Background note based on relevant findings from Eurobarometer data) Publication: December 2005, faqe 3.

⁴² Shiko faqen 20

agjensive të Kombeve të Bashkuara, njëloj perceptohet në të gjitha llojet e vendbanimeve edhe përkundër asaj që këto agjensi janë më aktiv në mjediset rurale dhe në mjediset më të vogëla urbane.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione:

- Trendi i mbështetjes së lartë të procesit të përafrimit drejt Bashkimit Evropian është indikativ edhe te popullata rinore, me çrast vërrehet një disparitet i butë në krahasim me mbështetjen te popullata e gjithëmbarshme, respektivisht, te popullata rinore manifestohet një përqindje më e ulët e mbështetjes.
- Mbështetja e lartë e procesit të përafrimit drejt Bashkimit Evropian dominon te të gjitha kategori demografike pa fluktacione të rëndësishme procentuale.
- Popullata rinore në Maqedoni i jep mbështetje më të lartë procesit evro-integrativ në krahasim me perceptcionet e të rinjve në vetë Bashkimin Evropian.
- Bashkimi Evropian dhe procesi i aderimit janë perceptuar si katalizatorë jashtëzakonisht të rëndësishëm të problemeve të caktuara në platformën socio-politike të Maqedonisë. Ekziston bindje e pranuar gjithëmbarshtëm për procesin e integritimit evropian si në proces i cili në masë të madhe do ti zgjidhë problemet ekzistenciale të të rinjve në Maqedoni.
- Parametrat kryesore për rritje ekonomike, respektivisht, për zhvillim ekonomik, investimet e drejtëpërdrejta të jashtme dhe zhvillimi teknologjik, janë perceptuar si përfitime kryesore nga procesi i integritimit evropian.
- Të rrinjtë shohin në Bashkimin Evropian një faktor shumë të rëndësishëm stabilizues.
- Gjysma e të rinjve në Maqedoni konsiderojnë se procesi evro-integrues do të ketë ndikim pozitiv mbi vlerat tradicionale dhe identitetin nacional.
- Të rinjtë në Maqedoni tregojnë afilacion të fuqishëm personal me procesin e integritimit evropian, duke e veçuar si faktor shumë të qenësishëm në projektionin e tyre vetanak për të ardhmën.
- Pritjet e të rinjve rreth hyrjes eventuale të Maqedonisë në Bashkimin Evropian janë reale dhe janë identike me opinionet e ekspertëve.
- Anëtarësimi i Maqedonisë në NATO gëzon mbështetje të lartë te të rinjtë në Maqedoni, gjë që indikon në një proces të pozicionimit më të fuqishëm të politikës së përafrimit drejt NATO-së.
- Ekziston mbështetje më e lartë të këtij procesi te Shqiptarët etnik kundruall Maqedonëve etnik.
- Shqiptarët e rinjë kanë afilacion më të fuqishëm drejt anëtarësimit në NATO si garantues i sigurisë personale, kundruall moshatarëve të tyre të bashkësisë Maqedone.


- Puna e agjensive të Kombeve të Bashkuara në Maqedoni nuk është e njohur shumë midis popullatës rinore, me çrast ka përqindje të lartë të të rinjve nuk njohin kurfarë ndikimi të këtyre agjensive në shoqërinë maqedone.
- Puna e agjensive të Kombeve të Bashkuara është shumë më e afër deri te Shqiptarët e rinjë, kundruall moshatarëve të tyre të bashkësisë maqedone.

Rekomandime:

- Të përforcohet dhe intensifikohet fushata informative për procesin e përafrimit të Maqedonisë drejt Bashkimit Evropian, me theks të veçantë te të rinjtë si grup i posaçëm qëllimor.
- Informim më i detajuar i popullatës rinore për përfitimet dhe pasojat që dalin nga procesi i evro-integritimit, të mbështetura me një informim objektiv rreth debatit për fuqinë absorbuese të Bashkimit Evropian.
- Përforcimi i procesit reformues në drejtim të sigurimit të komplementaritetit me programet rinore të Bashkimit Evropian dhe përforcimi i mobilitetit dhe komunikimit të të rinjve në Maqedoni me moshatarët e tyre në Bashkimin Evropian.
- Të përforcohen kapacitetet administrative për absorbimin e fondeve aderuese evropiane në drejtim të sigurimit të një zhvillimi real ekonomik.
- Të sigurohet një shkallë më e lartë e informimit të të rinjve rreth rolit të Bashkimit Evropian në Maqedoni dhe, para se gjithash, vlerat dhe idetë që ajo i përfaqëson.
- Të sigurohet një proces i vazhdueshëm i informimit të të rinjve rreth kontributeve nga anëtarësimi në NATO, si dhe rreth vetë rolit të NATO-së në kontekstin rajonal dhe global.
- Të përforcohen përpjekjet rreth vendosjes të një besimi më të madh në institucionet vendase të sigurisë te të rinjtë Shqiptarë.
- Qasje ë intensive deri te opinionin dhe komunikim i projekteve të ndryshme që implementohen nga ana e agjensive të Kombeve të Bashkuara.
- Të vërtetohen dhe analizohen shkaqet për perceptcionin e dobët të rolit të agjensive të Kombeve të Bashkuara te Maqedonët etnik.



ARSIMIMI





	Shkëlqyeshëm	Mirë	Keq	Shumë keq	Nuk di/ Nuk ka përgjigje
Fillor	15,1%	54%	24%	6,1%	0,81%
I mesëm	9,9%	53,7%	28,1%	7,6%	0,7%
Studime deri-diplomike	9,9%	42,4%	20,6%	12%	7,2%
Studime post-diplomike	10,1%	29,9%	15,3%	7,6%	37,1%

Tabelën 13. Percepioni i të rinjëve për cilësinë e arsimit në Republikën e Maqedonisë

Percepione për cilësinë e procesit arsimor

Pjesa e tretë e Hulumtimit për pritjet e të rinjëve i përfshinë perceptcionet e të rinjëve në lidhje me cilësinë e arsimit, preferencionet e tyre në lidhje me llojin e sistemit arsimor, perceptcionet në lidhje me arsimimin dhe tregun e punës në Republikën e Maqedonisë, si dhe potenciali për studime në botën e jashtme. Të dhënat e anketimit treguan trende dhe perceptcione që janë në suazat e asaj që është prituri, por edhe momente të reja zhvillimore në sfera të caktuara të aspekteve arsimore të përfshirë me këtë anketim.

Pjesa e parë e anketimit ka të bëjë me **vlërësimin e cilësisë të arsimit** në Republikën e Maqedonisë edhe atë në të gjitha shkallët e arsimit: primar (fillor), sekondar (i mesëm), studime deri-diplomike (i lartë) dhe studime post-diplomike. Respondentët u pyetën që të japin vlerësimin suazat e katër opsioneve që i kishin në dispozicion edhe atë: shkëlqyeshëm, mirë, keq dhe shumë keq. Paraqitur në mënyrë tabelare të dhënat për perceptcionet e të rinjëve në Maqedoni në lidhje me cilësinë duken poizitivisht. **Tabelën 13.**

Ajo që është evidente nga paraqitja tabelare është se të rinjtë në Republikën e Maqedonisë janë **kryesisht të kënaqur** nga cilësia e arsimit, edhe pse mund të konstatohet se ekziston një odium i fuqishëm i disponimit negativ në lidhje me disa shkallë të caktuara të arsimit. Ky odium negativ është më i shprehur te arsimimi i mesëm (35,7% të të anketuarëve kanë qëndrim negativ), por është dukshëm më i vogël edhe te studimet deri-diplomike (32,6%). Për praninë e skepticizmit ndaj cilësisë së arsimit te të rinjtë, flet edhe përqindja relativisht e ulët i të anketuarëve të cilët kanë vendosur që kategoritë e ofruara arsimore të vlerësojnë si të shkëlqyeshme.

Është evidente edhe tendenca sipas të cilës të rinjtë janë më skeptik ndaj shkallëve më të larta arsimore, kurse

vlërësimi për cilësinë bie, sikurse që shkohet nga arsimimi fillor deri te arsimimi post-diplomik. Kështu, perceptcion pozitiv për arsimimin fillor kanë 69,1%, për arsimimin e mesëm 63,6%, për studimet deri-diplomike 52,3%, kurse për studimet post-diplomike vetëm 22,9%. Njëri nga sqayrimet për këtë situatë është ndoshta shkalla e paragjykimeve që të rinjtë i kanë ndaj shkallëve më të larta të arsimit, duke patur parasysh se një përqindje shumë e vogël e të rinjëve në Maqedoni regjistrohen në fakultetet e shtetit, aq më pak i përfundojnë, kurse numri i të post-diplomuarëve (specializant, magjistër dhe doktorant) është në suaza shqetësuese.

Të dhënat e Entit për statistikë të Republikës së Maqedonisë⁴³ po e vërtetojnë këtë pohim në saje të rrënies rapide të nxënësve të regjistruar me çdo shkallë të ardhshme të arsimit. Kështu, për shembull, në vitin 2005 të dhënat janë shumë interesante. **Tabelën 14.**

Ky indikator shqetësues tregon se nga ata njerëz të rinjë që fillojnë arsimimin fillor më pask se 0.1% arrijnë deri te shkalla post-diplomike e arsimit, kurse vetëm 2,4% arrijnë të vijnë deri te diploma e fakultetit.⁴⁴ Kjo, gjithsesi ofron një sqarim të pjesërishëm edhe për **rënien e tendencës në aftësinë që të vlerësohet cilësia e arsimit** duke patur parasysh se 7,2% nga të anektuarit nuk kanë ditur që ta vlerësojnë cilësinë e arsimit të lartë, kurse, madje, 37,1% të arsimit post-diplomik në Maqedoni. Kjo mund të indicon se edhe ato vlerësime që janë dhënë për shkallët më të larta të arsimit (deri-diplomike dhe post-diplomike) janë reduktuar në përshtypje sipërfaqësore dhe se këto shkallë të arsimit duken si të paarrishme për një numër të madh të të anketuarëve të rinjë në Republikën e Maqedonisë. Demotivimi i një pjese të madhe të masës së nxënësve në këto kushte është, gjithsesi, një pasojë e logjikshme e rethanave të dhëna.

Se problemet në arsimimin e Republikës së Maqedonisë në pjesë të madhe janë të locuara në shkallët

	Numri i nxënësve të regjistruar / të kryer
Arsimimi fillor (të regjistruar)	218.935
Arsimimi i mesëm (të regjistruar)	95.867
Studime deri-diplomike (të regjistruar)	48.368
Studime deri-diplomike (të kryer)	5.397
Magjistër dhe specializant (studime post-diplomike - të kryer)	198 (189 + 9)

Tabelën 14. Numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar/të kryer sipas shkallëve arsimore në vitin 2005
Burimi: Enti për statistikë të Republikës së Maqedonisë

⁴³ Të dhënat mund të gjenden në www.stat.gov.mk. Vërejtje: të dhënat nuk i përfshijnë statistikën e Universitetit shtetëror në Tetovë dhe Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. Ata nuk ia kanë dërguar të dhënat veta Entit për statistikë për vitin 2005

⁴⁴ Raporti ka të bëjë me vitin 2005.

	1999	%	2000	%	2001	%	2002	%	2003	%
Numri i përgjithshëm i studentëve që kanë diplomuar pas 3 vjet (të diplomuar para kohe)	34	0,9	25	0,7	22	0,6	6	0,1	/	/
Numri i përgjithshëm i studentëve që kanë diplomuar pas 4 vjet (me kohë)	85	2,3	82	2,2	59	1,7	66	1,8	23	0,5
Numri i përgjithshëm i studentëve që kanë diplomuar pas 5 vjet	911	24,4	825	22	768	22	763	21,6	1.028	23,3
Numri i përgjithshëm i studentëve që kanë diplomuar pas 6 vjet	650	17,4	715	19	626	18	687	19	853	19,3
Numri i përgjithshëm i studentëve të diplomuar	3.735		3.740		3.480		3.618		4.404	
Numri i përgjithshëm i studentëve që kanë diplomuar pas 7 ose më shumë vjet	2.089	55,9	2.118	57	2.027	58	2.082	57,5	2.500	56,7

Tabelën 15. Kalueshmëria e studentëve në edukimin terciar në Republikën e Maqedonisë në periudhën 1999 – 2003⁴⁵

më të larta të arsimimit flet edhe një fakt tjetër. Ndërkaq, të dhënat e HPR-hulumtimit, por edhe të dhënat e Entrit për statistikë të Republikës së Maqedonisë, qartazi indikojnë se shkallët më të larta të arsimimit janë problematike në kuptimin e **kalueshmërisë së dtudentëve** edhe atë nga më shumë aspekte. Tabelën 15

Nuk bëhet fjalë vetëm për pamundësinë që të vlerësohet cilësia e këtyre shkallëve arsimore (si pasojë e mungesës reale të participimit në të njejtat), ose, madje, për zvogëlimin e pasqyrës pozitive drejt arsimimit terciar, sa që bëhet fjalë për për shkallën reale të ulët të kalueshmërisë të studentëve në arsimimin terciar, që, gjithsesi, është faktor tejet demotivues dhe hendikepues për të rinjtë në Maqedoni.

Kjo, gjithsesi, reflektohet në kapacitetin e shtetit në nivel të gjithëmbarshtëm në lidhje me tregun e punës në suaza më të gjëra, kurse gjendja në sektorin arsimor kërkon reforma esenciale ose të pjesërishtme, që është qëndrim e pjesës më të madhe të të rinjve në Maqedoni. Por, para se të kalohet në çështjen për nevojën e reformave në sektorin arsimor, nevojitet që të sqarohen perceptcionet e të rinjve për dy aspekte të procesit arsimor, që janë vital në kuptimin ekonomik: fitimi i shkathtësive praktike në procesimin e arsimimit dhe besimi në gjetjen e punës adekuate me shkallëm e arsimimit të fituar në momentin e realizimit të hulumtimit.

Shkathtësitë praktike, tregu i punës dhe procesi arsimor

Edhe pse pasqyra për cilësinë e arsimimit në Republikën e Maqedonisë mund të vlerësohet si mesatarisht e kënaqëshme me përqindje të rëndësishme të të rinjve skeptik, e njejtat, për fat të keq, nuk mund të thuhet për perceptcionet e të rinjve në lidhje me **ofertën e shkathtësive praktike** nga ana e procesit arsimor. Pasqyra e gjithëmbarshtëmë në lidhje me këtë çështje mund të vlerësohet si **e pakënaqshme** në saje të 72,5% të të anketuarëve që janë përgjigjur se sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë ofron mundësi të përkufizuara ose

kurfare mundësie për përfitimin e shkathtësive praktike (36,9% - mundësi të përkufizuara, 35,9% - nuk ofron kurfarë mundësie për përfitime me shkathtësi praktike). Ky është konsensus i lartë në lidhje me këtë çështje, nëse kihet parasysh distribuimi i barabart të të gjitha grupeve etnike, kategori arsimore, si dhe të stratimet tjera demografike të të rinjve të anketuar prej 18 deri 30 vjet.

Çështja e ofertës të shkathtësive praktike është e ndërlikuar ngushtë me perceptcionin e të rinjve në lidhje me **potencialin për gjetje të punës** pas përfundimit të shkallëve adekuate arsimore. Edhe në këtë rast, më së paku mund të konstatohet një **skepticizëm**, që jep indikatorë të disfavorshëm për përkatëshmërinë e procesit arsimor dhe adaptueshmërinë e tij ndaj tregut të punës në Maqedoni dhe më gjër. Kështu, 54,7% të të anketuarëve konsiderojnë se vështirë do të gjejnë punë, kurse 10,5% prej tyre janë edhe më skeptik, duke deklaruar se asnjëherë nuk do të gjejnë punë me shkallën përkatëse të arsimimit. Kjo sjellë deri te 65,2% prej të anketuarëve me qëndrim negativ në lidhje me këtë çështje. Normalisht, krahasuar në të gjitha kategoritë të të anketuarëve, më skeptik janë ata me shkallë më të ulët të arsimimit (deri te fillor, fillor, i mesëm), por skepsa nuk është zvogëluar në mënyrë rapide edhe te kategoritë e të anketuarëve të rinjë me arsimim të lartë dhe superior. Kjo tregon një dëshprim të përgjithshëm në lidhje me potencialin për gjetjen e punës te të gjitha kategoritë e të rinjve, që është, gjithsesi, një indikator serioz ekonomik, para se gjithash.

Këto dy indikatorë ngushtë të ndërlikuar tregojnë edhe një dimension të punëve në suazat e tematikës arsimore. Ndërkaq, vetëm 13,2% të të anketuarëve janë përgjigjur se duhet ta plotësojnë arsimimin me qëllim që të gjejnë punë adekuate. Kjo si e dhënë vetvetiu nuk do të thotë asgjë, por në konstelacion me të dhënat tjera të fituara nga HPR-hulumtimi, indikon një fenomen shumë serioz. Më saktë, 60,75% të të anketuarëve konsiderojnë se edukimi është shumë i rëndësishëm për sigurimin e një zhvillueshmërie më të madhe ekonomike, kurse 30,2% të

⁴⁵ Burimi: Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë

njejtin e konsiderojnë për të rëndësishëm në këtë kuptim. Kjo tregon se edukimi **njihet** si faktor përgjegjës në përmirësimin e pozitës vetanake dhe si faktor shumë ndikues në ekonominë e një shteti. Parashtrohet pyetje: përse atëhere vetëm 13,2% të të anketuarëve (pjesa më e madhe me arsimim më të ulët) do të vendosnin që ta plotësojnë arsimimin me qëllim të gjejnë punë më të mirë?

Një pjesë e përgjigjës është shumë i qartë: të rinjtë besojnë në edukimin, por janë **skeptik ndaj sistemit arsimor vendas për të cilin nuk besojnë (ose një pjesë shumë e vogël beson) se realisht do tua rritë shansat në tregun e hapur të punës**. Nëse kësaj i shtohet edhe rezerva e rëndësishme e të anketuarëve ndaj ofertës të shkathtësive praktike, pasqyra për sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë në sytë e të rinjëve seriozisht është sjellë në pikëpyetje. Si shtesë kësaj për këtë tezë flasin edhe të dhëna tjera nga hulumtimi.

Studimi jashtë shtetit, destinacionet e dëshiruara dhe „brain-drain“ fenomeni

Në një konstelacion të ngushtë me të gjitha aspektet e deritashme të paraqitur të perceptioneve të të rinjëve në lidhje me procesin arsimor, qëndrojnë edhe qëndrimet në lidhje me studimin jashtë shtetit dhe destinacionet e dëshiruara për studim. Thënë më saktësisht, vetëm 17,4% të të anketuarëve do të zgjedhnin që të studiojnë në suazat e shtetit, gjë që haptazi indikon perceptonin e të rinjëve në Republikën e Maqedonisë për superioritetin e (ri)edukimin e tyre jashtë Maqedonisë në lidhje me arsimimin e tërësishëm vendas. Gjithsesi, shkalla e pajtimit në lidhje me nevojën për edukim të jashtëm lëviz apropos fitimit të shkallëve të dëshiruara, prandaj 45,6% të të anketuarëve janë vendosur për një arsimim të tërësishëm jashtë Maqedonisë, përdorisa 31,2% të të rinjëve konsiderojnë se arsimimi parcial jashtë shtetit është një zgjidhje më e mirë. Megjithatë, mundet me një shkallë të madhe të sigurisë të konstatohet se **76,8% të të rinjëve në Maqedoni mundësinë për fitimin e një pjese ose të tërësishme të arsimimit jashtë shtetit e perceptojnë si opcion të dëshiruar**.

Se **emigrimi i trurëve të arsimuar**, për çka HPR-hulumtimi tregoi se ekziston një disponim adekuat, është realitet në Republikën e Maqedonisë, flasin edhe analizat e një pjese të madhe të ekspertëve që mirren me këtë çështje. Kështu, në revistën Southeast European Politics u paraqit një analizë interesante e shkencëtarit të ri m-r Vedran Horvat, e cila tregon (duke u bazuar në hulumtimin e bërë nga ana e Institutit ekonomik në Shkup) se në "dekadën e fundit midis 12000 dhe 15000 të rinjëve, të edukuar dhe superior të aftësuar e kanë braktisur shtetin⁴⁶, kurse, madje „85% të të rinjëve të Maqedonisë planifikojnë ose dëshirojnë ta braktisin shtetin pas kryerjes së studimeve“⁴⁷.

Për **motivacionin të këtij procesi „brain-drain“**, nuk janë fajtorë vetëm dobësitë e procesit arsimor, prandaj në këtë kuptim nuk mund të konkludohet me siguri a thua motivet për migracionin edukativ gjithmonë janë kryesisht të natyrës edukative. Në këtë kuptim, të anketuarit në HPR-hulumtimin e vërrejnë shkallën e lartë emigruese, por motivacioni për të njejtën nuk e shohin në arsyt personale (në të cilën do të kyçet edhe arsimimi më i mirë), por, më së shumti e loçojnë në situatën e pavolitshme ekonomike në shtet (83,5% janë përgjigjur se arsyt për migrimin nga Maqedonia janë të natyrës ekonomike). Kjo sjellë deri te dyshimi për motivacionin e migracionit edukativ nga

Maqedonia, por edhe përkundër këtyre indikatorëve nevoja për një edukim më të mirë jashtë shtetit nuk mund të lehet pas dore në asnjë kuptim.

Megjithatë, çështja e destinacionit të dëshiruar i zbulon edhe aspiratat e qytetarëve të rinjë të Republikës së Maqedonisë në lidhje me destinacionet e preferueshme për (ri)arsimim. Si destinacion më i popullarizuar veçohen shtetet e Bashkimit Evropian për të cilat janë përcaktuar diçka më shumë se gjysma e të rinjëve të Maqedonisë (52%). Si destinacion shumë i popullarizuar paraqiten edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të cilat janë deklaruar 30,1% të të anketuarëve. Cendet e rajonit si destinacion i dëshiruar për fillimin ose vazhdimin e procesit arsimor janë shumë më pak të popullarizuara me vetëm 8,5% të përgjigjeve të deklaruara.

Reforma e sistemit arsimor, sistem i preferuar i arsimimit, universitete private dhe shtetërore

Për seriozitetin e gjendjes në sektorin arsimor në Republikën e Maqedonisë flet edhe perceptoni i të rinjëve nga i gjithë shteti në lidhje me **nevojen për reforma në arsimimin**. Në lidhje me këtë çështje, që në njëfarë mënyre paraqet sumim i të gjitha qëndrimeve paraprake, ekziston një qëndrim i qartë dhe i definuar në mënyrë precize të të rinjëve i cili qartazi kërkon reforma (thelbësore) në sistemin arsimor. Kështu, grupi më i madh statistikor i qytetarëve të rinjë të Maqedonisë (46,9%) deklarohet për reforma thelbësore në sistemin arsimor, përdorisa 42,8% konsiderojnë se arsimimi në shtetin tonë duhet të kalojë nëpër një shkallë të caktuar të reformave. Duke patur parasysh se vetëm 4,8% të të rinjëve konsiderojnë se sistemin arsimor nuk i nevoiten reforma, mesazhi i të rinjëve drejtuar faktorëve përgjegjës për sistemin arsimor është mëse i qartë, edhe përkundër asaj që të rinjtë nuk deklarohen në pjesë të madhe negativisht të pyetur për cilësinë e sistemit arsimor.

Në kuptimin e drejtimit të reformave që seriozisht qëndrojnë para Republikës së Maqedonisë, locimi i **sistemit më të dëshiruar të arsimimit** të të rinjët është me rëndësi kyçe. Pikërisht për këtë, kurse në dritën e liberalizimit tanimë të vazhdueshëm të tregut arsimor, duket se ekziston një inklinacion serioz nga modeli i arsimimit të sponsoruar shtetëror të të rinjët në Republikën e Maqedonisë. Në këtë kuptim, 31,8% të të rinjëve janë përcaktuar për arsimim privat si modus i dëshiruar kundruall 27,3% të cilët ende konsiderojnë se sistemi shtetëror është zgjidhja më e mirë. Për një zgjidhje kompromise janë deklaruar 26,7%, respektivisht, kjo është masa statistikore e të rinjëve që angazhohet për një sistem të përzier të arsimimit.

Kësaj çështjeje i ndërlidhet edhe dilema për preferencialët dhe aspiratat e të rinjëve në lidhje me **llojin e universitetit** për të cilin konsiderojnë se ofron cilësi të mirë. Në lidhje me iniciativën gjithnjë e më të pranueshme private në sferën e arsimimit superior, mund të konstatohet polarizimi në lidhje me zgjedhjen e institucionit superior arsimor. Kështu, 25,3% të të anketuarëve konsiderojnë se universitetet private ofrojnë cilësi më të mirë, kundruall 18% të të rinjëve të cilët përparësitë komparative i loçojnë në universitetet shtetërore. Kjo me siguri qëndron në korelacion me mundësitë personale për studime dhe është rezultat i arritshmërisë së shkollimit privat që është shumë më i shtrenjtë në krahasim me kuotat shtetërore të regjistrimit.

Vëmendje jo më të pak të rëndësishme tërheqin edhe

⁴⁶ Horvat, Vedran. "Brain Drain – Threat to Successful Transition in South East Europe". Southeast European Politics. Vol. V. No.1. June 2004. faqe 84

⁴⁷ Ibid

26,1% të të anketuarëve të cilët konsiderojnë se universitetet private ofrojnë qasje të lehtë deri te diploma, që seriozisht ndikon mbi perceptimin për **cilësinë e arsimit superior privat**. Por, edhe pse kjo është përqindje serioze e të anketuarëve, nëse duhet të nxirret konkludimi nga pasqyra e gjithëmbarshme, është e qartë se universitetet private gjithnjë e më shumë penetrojnë në vetëdijen e njerëzve të rinjë si opcion për studime (në llogari të universiteteve shtetërore), por edhe se ende ekziston një masë e madhe skeptike të të rinjëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve që ata i ofrojnë.


KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione:

- Të rinjët në Republikën e Maqedonisë e perceptojnë sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë si relativisht të mirë.
- Vlerësimi për cilësinë e arsimit në Maqedoni bie me secilën shkallë të ardhshme të arsimit.
- Popullata rinore në Republikën e Maqedonisë është e pakënaqur nga shkathtësitë praktike që i ofron sistemi arsimor. Ndërlidhur me këtë, ekziston edhe një skepticizëm rreth mundësisë për gjetjen e punës me shkallën ekzistuese të arsimit.
- Të rinjët nuk besojnë se riedukimi në sistemin arsimor në Maqedoni do tu mundëson pozicion më të mirë në tregun e punës.
- Te të rinjët në Republikën e Maqedonisë ekziston dëshirë për fitimin e edukimit jashtë shtetit.
- Të rinjët në Maqedoni pajtohen rreth nevojës për një reformë thelbësore të sistemit arsimor.
- Ekzistojnë opinione të ndara të të rinjët rreth sistemit të preferuar të arsimit. Edhe pse universitetet private në Republikën e Maqedonisë fitojnë pozicion gjithnjë e më serioz, ekziston një dozë e madhe e skepticizmit ndaj cilësisë së tyre.

Rekomandime:

- Të vendoset një sistem për evaluimin e cilësisë të arsimit në Republikën e Maqedonisë në krahasim me vendet e Bashkimit Evropian.
- Theksi të vendosët më shumë në shkathtësitë praktike në procesin arsimor në Maqedoni.
- Të vendosen lidhje midis institucioneve superiore arsimore dhe punëdhënësve në tregun e punës.
- Në mënyrë më thelbësore të analizohen arsyet për skepticizmin e të rinjëve ndaj sistemit arsimor në Maqedoni.
- Të bëhet një analizë për reformën arsimore, veçanërisht në arsimimin superior dhe të vazhdohet me reformat e deritashme të ndërlidhur me procesin e Bollonjës.



EKONOMIA DHE MIGRACIONE





Edhe pse ndoshta pjesa e fundit e analizës të Hulumtimit për pritjet e të rinjëve (realizuar nga Instituti për demokraci nga Shkupi, në bashkëpunim me Friedrich Ebert Stiftung) ekonomia dhe migracionet paraqesin një komponent shumë të rëndësishme nga jeta e një njeriu të ri, sepse proceset ekonomike janë determinatna themelore e cila e përcakton zhvillimin e tij të mëtejshëm në shoqëri, por edhe në familje si qelizë themelore e participimit të njeriut në bashkësi.

Sikurse që është prezantuar edhe në vetë titullin, kjo kapitlinë përfshinë dy tema të posaçme, të cilat, megjithatë, janë në ndërvlerë të madhe: Ekonomia dhe migracionet.

Ekonomia

Në tabelën 16 janë prezantuar indikatorët themelor ekonomik në Republikën e Maqedonisë. Edhe pse, në disa kategori ekonomike vërrehet rritje e caktuar, megjithatë, ajo nuk e mjaftueshme që të shkaktoj stabilizimin e dy komponentave jashtëzakonisht të rëndësishme ekonomike,

midis të cilave ndoshta problem më flakëruar në Maqedoni, papunësia⁴⁹, që është një nga determinantet themelore të zhvillimit ekonomik në Maqedoni në sajë të deficitit të përhershëm të vendeve të punës, por edhe me mbulimin e importit me eksport, respektivisht deficitit të madh në tregëtinë e jashtme.

Pikërisht këto indikatorë janë shkaku që pothuajse gjysma (44,8%) e të anketuarëve po e potencojnë papunësinë si problem aktual më i madh në Republikën e Maqedonisë dhe në të njejtën kohë 87,8% të të rinjëve në këtë hulumtim, në pyetjen: Sipas juve, cila është situata aktuale ekonomike në shtet, të përgjigjen e keqe ose shumë e keqe. Megjithatë, medoemos duhet të theksohet se një e treta e të anketuarëve konsiderojnë se situata do të përmirësohet në periudhën e ardhshme, që paraqet qasje relativisht optimiste, në krahasim me anketimet që e përfshijnë popullatën e gjithëmbarshme, sepse te të anketuarit që i përfshijnë të gjitha grupet e moshave vetëm 18% konsiderojnë se ekonomia do të gjallëron në periudhën e ardhshme.⁵⁰ Ky dallim në përgjigjet ka të bëjë me një

	2001	2002	2003	2004
BPV në çmime rrjedhëse (milione denarë)	233.841	243.970	251.486	265.257
BPV në denarë nga viti 1995 (në milionë denarë)	187.342	188.941	194.988	/
Shkalla e rritjes reale të TVSH-së	-4.5	0.9	3.2	4.1 1)
BPV për banor në SHBA \$	1.830	1.859	2.230	2.382
Popullatë në mesin e vitit	2.035	2.020	2.027	2.032
Popullatë ekonomikisht aktive	862	825	861	832
Numri i të punësuarëve sipas ARS-së	599	561	545	523
Numri i të papunësuarve sipas ARS-së	263	263	316	309
Persona jashtë fuqisë së punës	692	742	718	762
Shkalla e papunësisë sipas ARS-së	30.9%	31.9%	36.7%	37.2%
Shkalla e aktivitetit	55.5%	52.6%	54.5%	52.2%
Shkalla e punësimit	38.6%	35.8%	34.5%	32.8%
	2002	2003	2004	2005
Shkalla e rritjes së rrogave nominale	6.9	4.8	4.0	2.5
Shkalla e rritjes së rrogave reale	5.0	3.6	4.4	2.0
Neto-rroga mesatare e paguar për punëtor në SHBA \$ 1	174	218	/	256
Import	1.962.110	2.299.921	2.931.626	3.227.998
Eksport	1.115.527	1.363.252	1.675.877	2.041.265
	2002/2001	2003/2002	2004/2003	2005/2004
Indeksi i kostos së jetës	101.8	101.2	99.6	100.5
Indeksi i çmimeve me pakicë	101.4	102.4	100.9	102.1
Indeksi i çmimeve të prodhuesve të prodhimeve industriale	99.1	99.7	100.9	103.2

Tabelën 16⁴⁸

⁴⁸ Burimi: Enti për statistikë i Republikës së Maqedonisë www.stat.gov.mk

⁴⁹ Republika e Maqedonisë ka shkallë më të madhe të papunësisë në Evropë, e cila sipas vlerësimeve është rreth 38% www.intra.rbec.undp.org


⁵⁰ Të dhëna të huazuara nga hulumtimi i fundit për Early Warning Report, mars 2006, faqe 23

optimizëm më të madh të rinjët, edhe pse, megjithatë, brengos fakti që 2/3 prej tyre parashikojnë se situata do të mbetet e njëjtë ose, madje, edhe do të keqësohet.

Mirëpo, duhet të theksohet se gjysma e të rinjëve që kanë deklaruar se situata aktuale është e keqe ose shumë e keqe, konsiderojnë se ajo do të përmirësohet në të ardhmën. Si institucion më përgjegjës për zhvillimin e ekonomisë, pjesa më e madhe e të anketuarëve e nënvizojnë Qeverinë, respektivisht 63,1% të të rinjëve në Republikën e Maqedonisë konsiderojnë se pikërisht Qeveria do të duhet që ti zgjidhë çështjet më flakëruese ekonomike, si dhe korrupsionin i cili ka ndikim të drejtëpërdrejt mbi zhvillimin ekonomik. Ndërkaq, madje 72,4% të të rinjëve konsiderojnë se pikërisht problemi me korrupsionin është fajtori për rritjen e dobët ekonomike, kurse përqindje e njëjtë konsiderojnë se kjo ka të bëjë edhe me punën e dobët të institucioneve, para se gjithash, të Qeverisë. Nga kjo mund të konkludohet se korrupsioni ekziston në masë të madhe dhe për shkak të paiterimit të Qeverisë për ndalimin e saj. Si mbështetje të këtij konstatimi mund të nënvizohen të dhënat nga Raporti për paralajmërimin e hershëm⁵¹ ku pas papunësisë si problem më i madh (53%) pasoj pikërisht korrupsioni me 18%. Megjithatë, duhet të theksohet se 87,1% të larta të të anketuarëve janë edhe vetëkritik, sepse konsiderojnë se edhe shprehitë e dobëta të punës në masë të madhe ndikojnë në rritjen e ulët ekonomike. Ky konstatim mund të vërtetohet edhe me faktin se 85,6% të të rinjëve konsiderojnë se pikërisht me volum të zmadhuar të angazhimeve punuese personale më së shpejti mund ti rrisin të ardhurat e veta në të ardhmën.

Segment shumë i rëndësishëm i cili kontribuon për zhvillimin e ekonomisë, paraqet arsimimi cilësor, sikurse që tregojnë edhe rezultatet e hulumtimit. Në anketë u parashtruan dy pyetje që e tangojnë arsimimin dhe rritjen ekonomike. Nëse krahasohen përgjigjet në pyetjen për rëndësinë e arsimimit cilësor me pyetjen për ndikimin e arsimimit joadekuat mbi zhvillimin e dobët të ekonomisë, konfirmohet kjo ndërvarësi e arsimimit dhe ekonomisë. Ndërkaq, 56,9% të të anketuarëve të cilët e kanë potencuar si ndikim prioritar i cilësisë e arsimimit në zhvillimin e ekonomisë, janë përgjigjur se pikërisht arsimimi joadekuat është shkaku jashtëzakonisht i rëndësishëm për rritjen e ngadalshme ekonomike, që paraqet 34,6% nga numri i përgjithshëm i të anketuarëve në këtë hulumtim.

Njëri nga problemet themelore ekonomike që drejtëpërdrejt ndikon mbi shkallën e papunësisë dhe mbi saldon negative në shkëmbimin tregëtar, paraqet edhe



Grafikoni 4.⁵²

⁵¹ Ibid

⁵² Burimi: Enti për statistikë i Republikës së Maqedonisë www.stat.gov.mk

⁵³ www.cia.gov/worldfactbook/macedonia

vëllimi i ulët i investimeve të drejtëpërdrejta të jashtme (IDJ). Në grafikoni 4 janë prezantuar mjetet e gjithëmbarshme që janë investuar në Republikën e Maqedonisë nga kompani të jashtme në nivel vjetor. Këtë problem po e perceptojnë edhe të rinjët, prej të cilëve 91% i kanë nënvizuar pikërisht investimet e drejtëpërdrejta të jashtme si të rëndësishme ose si shumë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë dhe për zvogëlimin e papunësisë. Nga të rinjët, preokupimi kryesor i të cilëve është pikërisht ekonomia dhe biznesi, kjo përqindje është edhe më e madhe dhe është 94,1%, respektivisht 18,5% nga numri i përgjithshëm i të anketuarëve. Midis shkaqeve për shkallën e ulët të investimeve të drejtëpërdrejta të jashtme është reforma e ngadalsuar në administratën dhe gjyqësinë. E gjithë kjo paraqet një problem serioz, në saje të asaj se investimet janë faktori kyç për zvogëlimin e papunësisë dhe rritjen e rritjes ekonomike dhe të prodhimit vendas. Ky konstatim konfirmohet edhe në hulumtimin ku 55,9% nga numri i përgjithshëm i të anketuarëve kursesi nuk kanë besim në gjyqësinë, kurse 51,9% të të rinjëve, njëherit, konsiderojnë se reforma në administratën është prioriteti më i lartë që të arrihet një rritje më e lartë ekonomike.

Njëri prej faktorëve që ndikojnë mbi zhvillimin e ekonomisë në Maqedoni paraqet integrimi evropian. Proceset evro-integruese kontribuan drejt një rritjeje më të lartë të ekonomive në vendet e Evropës Lindore dhe në të njëjtën kohë në zvogëlimin e papunësisë, veçanarisht midis të rinjëve. Perceptioni i të rinjëve në Republikën e Maqedonisë e vërteton këtë gjendje, respektivisht 90,1% të të anketuarëve që pozitivisht e mirëpresin integrimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian (BE), konsiderojnë se ai do të sjellë një zhvillim më të madh dhe më të shpejtë ekonomik. Prandaj, mund të konkludohet se nxitës themelor i reformave në Maqedoni, që janë inicuar nga ana e Bashkimit Evropian dhe të cilat duhet ta rrishtojnë ekonominë e Maqedonisë, por edhe segmenetet tjera të shoqërisë, paraqet optimizmi për një zhvillim më të lartë ekonomik përmes benefiteve që i ofron Bashkimi Evropian. Njëherit, statusi - kandidat i Republikës së Maqedonisë dhe inisiativa për fillimin e negociatave për aderim në Bashkimin Evropian, mund që ti tërheqë investitorët e jashtëm të cilët do të sjellin kapital të freskët dhe do të kontribuonin për hapjen e vendeve të reja të punës, si dhe një rritje më të shpejtë ekonomike.

Edhe pse në Bruto prodhimin e vendit (BPV), bujqësia merr pjesë me 9,7%, industria me 28,8%, kurse shërbimet me 61,5%⁵³, pjesa më e madhe e të anketuarëve konsiderojnë se pikërisht zhvillimi i bujqësisë duhet të jetë prioriteti më i madh (41,4%), pastaj 34,8% e kanë deklaruar të njëjtën për industrinë, kurse vetëm 17,4% janë përcaktuar për shërbimet (21,3% të Shkupjanët), edhe pse ata më së shumti kontribuojnë në Bruto prodhimin e vendit. Nga kjo mund të konkludohet se perceptioni i të rinjëve në lidhje me zhvillimin sektorial të ekonomisë në masë të madhe është zhvendosur në lidhje me rrjedhave moderne ekonomike. Megjithatë, duhet të potencohet se ndikim të madh mbi perceptimet e këtylla kanë arsimimi, mediumet dhe opinioni i përgjithshëm i pranuar se bujqësia është dega më rëndësishme e ekonomisë në Maqedoni e cila duhet të zhvillohet, në saje të traditës dhe kushteve të volitshme klimatike.

Gjithsesi se ishte i pritur qëndrimi i të rinjëve në lidhje me gjendjen e përgjithshme në ekonomi, komparuar me

situatën e tyre personale fiinanciare. Ndërkaq, te të rinjët të cilët kanë deklaruar se financiarisht qëndrojnë keq ose shumë keq, rezultatet janë të pritur, sepse shumica dërmuese prej tyre (93,5% të atyre që qëndrojnë keq dhe 96,2% të atyre që qëndrojnë shumë keq kanë deklaruar se edhe situata e gjithëmbarshme ekonomike nuk është në ndonjë nivel të kënaqshëm ose se është shumë e rëndë. Nga një aspekt i caktuar, befasi paraqet fakti se 58,5% të të rinjëve që kanë situatë të mirë financiare e perceptojnë gjendjen e gjithëmbarshme ekonomike si si jostabile. Kjo shpjen në konkludim se edhe pse një pjesë e të rinjëve personalisht janë të kënaqur nga të ardhurat e veta ose nga të ardhurat e familjes së vetë, megjithatë, konsiderojnë se kjo ka të bëjë kryesisht me punën personale ose ndoshta me rrethanat fatlume, e jo me zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik. Në saje të asaj se 41,6% të të rinjëve që morrën pjesë në këtë hulumtim, kanë deklaruar se gjendjet e tyre financiare janë të këqia ose shumë të këqia, kurse përqindje e përgjithshme i qytetarëve në Maqedoni që jetojnë nën pragun e varfërisë relative sipas të dhënave të pranura statistikore është 38%,⁵⁴ atëhere mund të pranohen konkluzionet e mëparshme si relevante për një analizim.

Përqindje e lartë e të anketuarëve konsiderojnë se mënyra më e mirë që ti rrisin të ardhurat është të fillojnë me biznes vetanë (32,9%). Megjithatë, vetëm 25,1% të të rinjëve që e kanë deklaruar këtë mendojnë se punësimi më i mirë është ai të cilin vetë ata do ta krijojnë. Nga ana tjetër, 37% të larta nga ata që kanë deklaruar se emigrimi është mënyra më e mirë për një siguri financiare, konsiderojnë se puna në administratën publike është punësimi më i mirë. E gjithë kjo rezulton me parashtrimin e disa hipotezave. Ndërkaq, të rinjët, para se gjithash, dëshirojnë të ndjehen të sigurt në kuptimin ekonomik dhe si pasojë nga kjo, ata edhe pse kanë parashtruar hipoteza të caktuara për mënyrën më të mirë që të vihet deri te financa, megjithatë frikësohen që të përpiqen këtë edhe ta realizojnë. Vetëpunësimi dhe emigrimi mund të sjellin dobi relativisht të lartë financiare, por nga ana tjetër, ata sjellin edhe rreziqe për realizimin e tyre. Prandaj, një pjesë e madhe e të rinjëve, megjithatë, më parë do të përcaktoheshin për një punë të paguar dobët, por të sigurt në administratën publike.

Kjo e parashtron edhe hipotezën e dytë e cila supozon se në 16 vitet e fundit shumë pak punë në vetëdijën e njerëzve kanë ndryshuar, veçanarisht në aspektin e punësimit. Thënë kushtimisht, "puna shtetërore" ende ka prioritet të larta, edhe pse shikuar nga ana materjale ajo nuk sjellë përfitim të madh financiar.

Migracione

Shkalla vjetore e emigracionit nga Maqedonia është 1,54 emigrantë në 1000 banorë.⁵⁵ Kjo do të thotë se mbi 3000 qytetarë, kryesisht të rinjë, çdo vit e braktisin shtetin. Madje, 60% të të anketuarëve konsiderojnë se kjo shkallë është tepër e lartë, kurse 32,6% plotësuere të të anketuarëve konsiderojnë se ajo është e lartë. Vetëm 2,4% prej qytetarëve konsiderojnë se ajo është e ulët. E pritur, 82,4% të të rinjëve të cilët kanë deklaruar se mënyra më e mirë që ta përmirësojnë situatën e vetë financiare është që të emigrojnë, konsiderojnë se Maqedonët emigrojnë kryesisht nga shkaqwe ekonomike. Nëse shikohen tabelat e përgjithshme, ky numër është 83,5%. Kjo është e mjaftueshme që të konkludohet se emigrantët nga Maqedonia janë për shkaqe dominante ekonomike, kurse

shkaqet tjera janë pothuajse marginale. Ky konstatim mund të konfirmohet edhe me të dhënën se 46,8% të qytetarëve kushtet e jetës të cilëve janë shumë të këqia dhe 47,3% të të rinjëve që kanë deklaruar se kushtet janë të këqia, seriozisht e shqyrtojnë opcionin të emigrojnë. Në numra të përgjithshëm, seriozisht mendojnë të emigrojnë 35,1% të të anketuarëve, por, megjithatë, medoemos duhet theksuar se pjesa më e madhe prej tyre mbetin të jetojnë në atdheun e tyre.

Me qëllim që të caktohet përqindja e emigrantëve potencial të popullatës rinore që seriozisht mendojnë të emigrojnë dhe të mos këthehen më që të jetojnë në Maqedoni, u bë një krostabulacion, respektivisht kryqësimin e pyetjes – a thua planifikoni të emigroni, me pyetjen – sa do të mbeten jashtë, nëse emigrojnë. Në këtë mënyrë u konfirmua se 42,6% të të rinjëve që planifikojnë të emigrojnë, ata do të emigronin njëherë e përgjithmonë, respektivisht 15,7% nga numri i përgjithshëm i të anketuarëve. Ky është, në të vërtetë, përqindja e të rinjëve në Republikën e Maqedonisë të cilët ekzistojnë shansa më e madhe të largohen nga shteti. Këtë e vërteton edhe fakti se 44,4% të të rinjëve të cilët konsiderojnë se do tu përmirësohen kushtet e jetës në ardhmëri planifikojnë të emigrojnë njëherë e përgjithmonë, respektivisht largimin në botën e jashtme e shikojnë si opcion për ngritjen e standardit jetësor.

Në lidhje me rajonet më të dëshiruara në botë ku do të emigronin, kuptohet nëse vendosen për një hap të këtille, vërrehet se destinacionet më të largëta sikurse që janë; Amerika Veriore, Australia ose Zelanda e Re, më shumë e zgjedhin të rinjët të cilët poqese do të emigronin atje do të mbeteshin përgjithmonë. Nga ana tjetër, ata që planifikojnë ta braktisin shtetin për një periudhë më të shkurtrë kohore, më shumë e preferojnë Bashkimin Evropian.

Të rinjët në Republikën e Maqedonisë i ndajnë dhe i ndejnë problemet e njejta sikurse edhe pjesa tjetër e popullatës, me vërrejtje se, megjithatë, disa probleme dhe nevoja të caktuara janë më shumë të shprehura. Problemi themelor është papunësia dhe kuptohet se të rinjëve të cilët posa që duhet të bëhen pjesë e forcës punuese, nuk u pëlqen opioni të kyçen në armatën e të papunësuarëve ose, nga ana tjetër, të punojnë për dobi të vogël financiare ose punë që nuk u pëlqen. Prandaj, një pjesë prej tyre mendon edhe që ta braktis vendin duke kërkuar ardhmëri më të sigurt. Megjithatë, vëmendje meriton edhe fakti se të rinjët në një masë të madhe dijnë në mënyrë të drejtë ti përcaktojnë shkaqet për papunësinë e lartë, si dhe ti locojnë përgjegjësitë që do të duhet ti zgjidhin problemet me të cilët për çdo ditë ballafaqohen. Shkaku themelor për papunësinë ata e shohin në shkallën e ulët të rritjes ekonomike. Kjo, megjithatë, është vetëm pasojë nga vëllimi i vogël i investimeve të jashtme dhe reforma e ngadalsuar në administratën, e cila duhet ta ngrit nivelin e investimeve. Problem tjetër me të cilin po ballafaqohen është korrupsioni dhe prandaj konsiderojnë se pikërisht Qeveria është përgjegjëse për zgjidhjen e pengesave të lartëpërmendura që do të mundësonin hapjen e numrit më të madh të vendeve të punës.

Edhe pse të rinjët si më përgjegjës për zhvillimin e ekonomisë kurse me këtë për zvogëlimin e papunësisë e nënvizojnë pushtetin, megjithatë, ata locojnë edhe faktorë tjerë në lidhje me gjendjen e këtille. Midis tyre është arsimimi joadekuat, por edhe shprehitë e dobëta punuese, me çka një pjesë të përgjegjësive e marrin mbi vete. Prandaj,

⁵⁴ Ibid

⁵⁵ www.worldpress.org/profiles/macedonia.cfm

një pjesë e madhe prej tyre janë të gatshëm kryesisht me punën personale që ta përmirësojnë situatën e vet financiare, pa pritur me këtë rast dikush tjetër ta bëjë këtë, që supozon një avancim shumë i rëndësishëm në ndryshimin e vetëdijes te njerëzit, ku gjeneratat e mëparshme zakonisht pritin që shteti ose ndonjë sistem tjetër tua zgjidhë problemet.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME


Konkluzione:

- Problemet e përgjithshme ekonomike reflektohen edhe mbi popullatën rinore në Republikën e Maqedonisë.
- Problemet themelore për të rinjtë janë papunësia dhe korrupsioni.
- Më përgjegjës për zgjidhjen e problemeve ekonomike në vend sipas të rinjëve janë institucionet shtetërore.
- Institucionet shtetërore, sipas tyre, janë edhe më përgjegjëse për rritjen e dobët ekonomike dhe papunësinë.
- Megjithatë, ata një pjesë të përgjegjësisë e locojnë edhe mbi faktorët tjerë, duke e përfshirë edhe vehten.
- Problemi i madh paraqet edhe sistemi i vjetëruar arsimor i cili po reformohet, por, sipas tyre, në mënyrë të pamjaftueshme.
- Procesin e evro-integrimit e shikojnë si mundësi për një zhvillim më të shpejtë ekonomik dhe me këtë hapje të më shumë vendeve të punës.
- Sipas tyre, më së shumti duhet të investohet në bujqësi.
- Një pjesë e caktuar e të rinjëve mendon edhe për emigrim si mënyrë për zgjidhje më të shpejtë të problemeve ekonomike, respektivisht mënyrë që më shpejtë të gjejnë punë dhe mjete për jetesë.
- Megjithatë, një pjesë e madhe prej tyre migracionin e shikojnë si arletnativë e fundit.
- Pjesa më e madhe e të rinjëve që do të emigronin për një periudhë më të shkurtë e preferojnë Bashkimin Evropian, përderisa ata që do të emigronin për një periudhë më të gjatë ose përgjithmonë, i preferojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose Australinë.

Rekomandime:

- Zvogëlimi i papunësisë të të rinjëve të shtrohet si prioritet kulminant në politikën ekonomike të shtetit.
- Zvogëlimi i kontributeve për rroga për të gjithë kuadrot e reja deri në moshën 30 vjeçare, veçanarisht nëse ky është punësimi i tyre i parë.
- Sigurimi i kurseve papagesë për rikualifikim dhe kualifikim të plotësuar të të rinjëve me qëllim ata më lehtë të gjejnë punë.

- Promovim i „part-time job“, si mënyrë për rritjen e punësimit te popullata rinore dhe mënyrë për vetëbuxhetim gjatë kohës së studimeve.
- Fushatë promovuese përmes së cilës do të rretet vetëdija te të rinjtë në Republikën e Maqedonisë për:
 - Pranimin e një pjese të përgjegjësisë për zhvillimin ekonomik të shtetit
 - Angazhim më të madh personal për rritjen e të ardhurave vetanake
 - Pjesëmarrje aktive në reformat e arsimit dhe ekonomisë si parakusht për rindërtim më cilësor personal dhe shansa më të mëdha për sukses në planin afarist
 - Zvogëlimin e shkallës së kërkimit të përgjegjësisë për mospunësin personal afarist te institucionet shtetërore
 - Promovimin aktiv të mundësive të ndryshme për avancimin afarist të të rinjëve, që do të kishin për qëllim të tregojnë se migracioni nuk duhet të jetë alternativa prioritare.





SITUATA NË VEND DHE PERCEPCIONET E PËRGJITHSHME

Si i vlerësoni kushtet e Juaja për jetesë?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Shumë të mira	71	5.9
Të mira	350	29.2
Mesatare	503	42
Të këqia	220	18.4
Shumë të këqia	47	3.9
Pa përgjigje/Nuk di	6	0.5
Total	1197	100

A jeni anëtar i:

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Partisë politike	181	15.1
OJQ	95	7.9
Asociacionit sportiv	75	6.3
Shoqatës profesionale	24	2
Organizatës tjetër	26	2.2
Nuk jam anëtar i organizatekurfare	769	64.2
Pa përgjigje/Nuk di	27	2.3
Total	1197	100

Sipas mendimit Tuaj në cilin drejtim shkon Maqedonia?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Të vërtetin	179	15
Të gabuar	427	35.7
Nuk mund të them	472	39.4
Pë përgjigje/Nuk di	119	9.9
Total	1197	100

Cili është problemi më i madh aktualisht në Maqedoni?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Korrupsioni	320	26.7
Papunësia	536	44.8
Varfëria	257	21.5
Çështjet e sigurisë	4	0.3
Çështjet etnike	14	1.2
Kriminaliteti	29	2.4
Siguria sociale	3	0.3
Arsimimi	7	0.6
Mjedisi jetësor	5	0.4
Tjetër	8	0.7
Pa përgjigje/Nuk di	14	1.2
Total	1197	100

Nëse keni shansë, a thua personalisht do të kyçeni në zhvillimin e Maqedonisë?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Gjithsesi	732	61.2
Vetëm nëse kam dobi personale	233	19.5
Asnjëherë	120	10
Pa përgjigje/Nuk di	112	9.4
Total	1197	100

MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Poqese do të mbahej javën e ardhshme referendumi për pranimin e Maqedonisë në BE, si do të votoni?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Pro	883	73.8
Kundër	69	5.8
I pavendosur	128	10.7
Nuk votoj	96	8
Pa përgjigje/Nuk di	21	1.8
Total	1197	100

Poqese do të mbahej javën e ardhshme referendumi për pranimin e Maqedonisë në NATO, di do të votoni?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Pro	813	67.9
Kundër	108	9
I pavendosur	133	11.1
Nuk votoj	99	8.3
Pa përgjigje/Nuk di	44	3.7
Total	1197	100

Çfarë ndikimi do të ketë procesi i integrimit në BE mbi zhvillimin ekonomik?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Pozitivisht	990	82.7
Negativisht	47	3.9
Pa ndikim	62	5.2
Pa përgjigje/Nuk di	98	8.2
Total	1197	100

Çfarë ndikimi do të ketë procesi i integrimit në BE mbi investimet e drejtpërdrejta të jashtme?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Pozitivisht	1019	85.1
Negativisht	37	3.1
Pa ndikim	55	4.6
Pa përgjigje/Nuk di	86	7.2
Total	1197	100

Çfarë ndikimi do të ketë procesi i integrimit në BE mbi politikën vendase?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Pozitivisht	705	58.9
Negativisht	136	11.4
Pa ndikim	171	14.3
Pa përgjigje/Nuk di	185	15.5
Total	1197	100

Çfarë ndikimi do të ketë procesi i integrimit në BE mbi stabilitetin?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Pozitivisht	916	76.5
Negativisht	59	4.9
Pa ndikim	102	8.5
Pa përgjigje/Nuk di	120	10
Total	1197	100

Çfarë ndikimi do të ketë procesi i integrimit në BE mbi të drejtat e njeriut?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Pozitivisht	899	75.1
Negativisht	54	4.5
Pa ndikim	120	10
Pa përgjigje/Nuk di	124	10.4
Total	1197	100

Çfarë ndikimi do të ketë procesi i integrimit në BE mbi zhvillimin teknologjik?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Pozitivisht	927	77.4
Negativisht	48	4
Pa ndikim	82	6.9
Pa përgjigje/Nuk di	140	11.7
Total	1197	100

Çfarë ndikimi do të ketë procesi i integritit në BE mbi vlerat nacionale / identitetin?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Pozitivisht	681	56.9
Negativisht	148	12.4
Pa ndikim	156	13
Pa përgjigje/Nuk di	212	17.7
Total	1197	100

Anëtarësimi i Maqedonisë në NATO a do ta rritë sigurinë e Juaj personale?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Po, shumë	113	9.4
Po	290	24.2
Deri në një shkallë të caktuar	350	29.2
Jo	241	20.1
Kursesit	101	8.4
Pa përgjigje/Nuk di	102	8.5
Total	1197	100

ARSIMIMI

Në çfarë mase konsideroni se sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë ofron mundësi për fitimin e shkathtësive praktike?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Ofron mundësi të shkëlqyshme për ndërtimin e aftësive	38	3.2
Ofron mundësi të kënaqëshme për ndërtimin e aftësive	207	17.3
Ofron mundësi kufizuese për ndërtimin e aftësive	442	36.9
Ofron mundësi për ndërtimin e aftësive	430	35.9
Pa përgjigje/Nuk di	80	6.7
Total	1197	100

Nëse keni zgjedhje, çka do të zgjidhni?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Arsimim i jashtëm	546	45.6
Arsimim i brendshëm	208	17.4
Studime të pjesërishme në botën e jashtme	374	31.2
Pa përgjigje/Nuk di	69	5.8
Total	1197	100

Do të pajtoheni se:

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Universitetet shtetërore ofrojnë cilësi më të mirë nga universitetet private	215	18
Universitetet private ofrojnë cilësi më të mirë nga universitetet shtetërore	303	25.3
Universitetet private ofrojnë qasje të lehtë deri te diploma universitare	313	26.1
Edhe njërit edhe tjetrit janë të mirë	166	13.9
Edhe njërit edhe tjetrit janë të dobët	102	8.5
Pa përgjigje/Nuk di	98	8.2
Total	1197	100

Me cilat prej këtyre deklaratave pajtoheni?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Sistemit arsimor në Maqedoni i nevoiten reforma thelbësore	561	46.9
Sistemit arsimor na Maqedoni i nevoiten disa reforma	512	42.8
Sistemit arsimor në Maqedoni i nevoiten reforma	57	4.8
Pa përgjigje/Nuk di	67	5.6
Total	1197	100

EKONOMIA DHE MIGRACIONE

Si do ta përshkruani gjendjen e tanishme të përgjithshme ekonomike në Republikën e Maqedonisë?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
E shkëlqyeshme	14	1.2
E mirë	124	10.4
E keqe	634	53
Shumë e keqe	416	34.8
Pa përgjigje/Nuk di	9	0.8
Total	1197	100

Çfarë janë pritjet e Juaja për gjendjen ekonomike në disa vite të ardhshme?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Do të jetë më e mirë	379	31.7
Do të jetë e njejtë	443	37
Do të jetë më e keqe	200	16.7
Pa përgjigje/Nuk di	175	14.6
Total	1197	100

Cili sektor ekonomik duhet të jetë prioritar në Maqedoni?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Bujqësia	495	41.7
Industria	417	34.8
Shërbime (turizmi, bankierizmi, telekomunikimet, etj.)	208	17.4
Pa përgjigje/Nuk di	77	6.4
Total	1197	100

Cili është shkaku kryesor për migracione nga Republika e Maqedonisë?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Gjendja ekonomike	999	83.5
Shkaqet e sigurisë	23	1.9
Shkaqet personale joekonomike	70	5.8
Aventura	19	1.6
Perspektiva më të mira për fëmijët e Juaj	66	5.5
Tjetër	3	0.3
Pa përgjigje/Nuk di	17	1.4
Total	1197	100

A jeni duke menduar që të shpërnguleni nga Republika e Maqedonisë?

	Numri i të anketuarëve	Përqindje
Po	420	35.1
Ndoshta	474	39.6
Muk është shumë e sigurt	220	18.4
Jo	54	4.5
Pa përgjigje/Nuk di	29	2.4
Total	1197	100